

L I G J
Nr.9551, datë 5.6.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR GARANCITË
NDËRKOMBËTARE NË PAJISJET E LËVIZSHME” DHE NË PROTOKOLLIN E SAJ**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën “Për garancitë ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme”.

Neni 2

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin e Konventës “Për garancitë ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4931, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTË MBI GARANCITË NDËRKOMBËTARE NË PAJISJET E LËVIZSHME

Shtetet palë në këtë Konventë,
duke ditur nevojën e përfuturit dhe përdorimit të pajisjeve me vlerë të madhe ose rëndësi të veçantë ekonomike dhe për të lehtësuar financimin e përfuturit dhe përdorimit të këtyre pajisjeve në një mënyrë efektive;
duke njohur avantazhet e financimit bazuar mbi vlera pasurore dhe lisingut për këtë qëllim dhe me dëshirën për të lehtësuar këto lloj veprimesh juridike duke vendosur rregulla të qarta për t’i rregulluar ato;
duke menduar për nevojën e sigurimit që këto interesa në këto pajisje të njihen dhe të mbrohen në mënyrë universale;
me dëshirën për t’u dhënë përfitime ekonomike të gjera dhe reciproke të gjitha palëve të interesuara;
duke besuar që këto rregulla duhet të pasqyrojnë parimet e financimit të bazuar në vlera pasurore dhe lisingut dhe nxisin lirinë e nevojshme të palëve për kryerjen e veprimeve juridike;
të ndërgjegjshëm për vendosjen e një kuadri ligjor për garancitë ndërkombëtare në këto pajisje dhe për këtë qëllim ngritjen e një sistemi ndërkombëtar regjistrimi për mbrojtjen e tyre;
duke marrë parasysh objektivat dhe parimet e caktuara në konventat ekzistuese në lidhje me këto pajisje,
bien dakord për dispozitat e mëposhtme:

KAPITULLI I
FUSHA E ZBATIMIT DHE DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

Në këtë Konventë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm përdoren në kuptimin e vendosur më poshtë:

- a) “marrëveshje” është një marrëveshje garancie, marrëveshje për rezervë pronësie ose një marrëveshje lisingu;
- b) “kalimi i kredisë” është një marrëveshje që, nëpërmjet garancisë apo në mënyrë tjetër, i jep cesionarit të drejtat e garantuara së bashku me ose pa transferimin e garancive përkatëse ndërkombëtare;
- c) “të drejta të garantuara” janë të gjitha të drejtat për një pagesë apo një detyrim tjetër nga një debitor

në bazë të një marrëveshjeje që janë garantuar ose lidhen me objektin;

d) "fillimi i procedurës së falimentimit" është momenti në të cilin mendohet se fillon procedura e falimentimit në bazë të ligjit të zbatueshëm për falimentimin;

e) "blerës me kusht" është një blerës në bazë të një marrëveshjeje për rezervimin e titullit;

f) "shitës me kusht" është një shitës në bazë të një marrëveshjeje për rezervimin e titullit;

g) "kontratë shitjeje" është një kontratë për shitjen e një objekti nga një shitës tek një blerës, e cila nuk është një marrëveshje sipas përcaktimit në (a) më sipër;

h) "gjykatë" është një gjykatë e zakonshme ose një gjykatë administrative apo arbitrazhi e ngritur nga një Shtet Kontraktues;

i) "kreditor" është marrës i garancisë në bazë të një marrëveshjeje garancie, shitës me kusht në bazë të një marrëveshjeje për rezervimin e titullit, ose dhënës lisingu në bazë të një marrëveshjeje lisingu;

j) "debitor" është një dhënës garancie në bazë të një marrëveshjeje garancie, një blerës me kusht në bazë të një marrëveshjeje për rezervimin e titullit, ose një marrës lisingu në bazë të një marrëveshjeje lisingu, apo një person, e drejta e të cilit në një objekt rëndohet me një të drejtë të regjistrueshme ligjore.

k) "administrator falimentimi" është një person i autorizuar të administrojë riorganizimin ose likuidimin edhe nëse është i autorizuar përkohësisht dhe përfshin një debitor në vetadministrim, nëse kjo lejohet nga ligji i zbatueshëm për falimentimin;

l) "procedurë falimentimi" është një procedurë falimentimi, likuidimi ose tjetër gjyqësor ose administrativ, duke përfshirë procedurat paraparake, në të cilën sendet dhe veprimet e debitorit i nënshtrohen kontrollit ose mbikëqyrjes së gjykatës për qëllimet e riorganizimit ose likuidimit;

m) "personat e interesuar" janë:

i) debitori;

ii) çdo person që, për qëllimet e sigurimit të përmbushjes së një detyrimi në favor të kreditorit, merr përsipër një dorëzani ose jep një garanci një *standby letter of credit* apo çdo formë tjetër për sigurimin e kredisë;

iii) çdo person tjetër që ka të drejta në një objekt.

n) "veprim juridik i brendshëm" është një veprim juridik i përfshirë në listën e nenit 2(2)(a) deri (c) ku ndodhet qendra e interesave kryesore të të gjitha palëve në një veprim të tillë dhe objekti përkatës (sipas parashikimit të Protokollit), në të njëjtin Shtet Kontraktues në momentin e lidhjes së kontratës dhe ku garancia e krijuar nga veprimi juridik është regjistruar në një regjistër kombëtar në atë Shtet Kontraktues që ka bërë një deklaratë në bazë të nenit 50(1);

o) "garanci ndërkombëtare" është një garanci që e ka një kreditor për të cilën zbatohet neni 2;

p) "regjistër ndërkombëtar" janë pajisjet për regjistrim ndërkombëtar, i krijuar për qëllimet e kësaj Konvente ose Protokollit;

q) "marrëveshje lisingu" është një marrëveshje nëpërmjet së cilës (dhënësi i lisingut) i jep të drejtën e zotërimit ose disponimit të një objekti (me ose pa opsionin e blerjes) një personi tjetër (marrësit të lisingut) si shpërblim për qiranë lising ose një pagesë tjetër;

r) "garanci kombëtare" është një garanci e kreditorit në një objekt dhe të krijuar nga një veprim juridik që mbulohet nga një deklaratë në bazë të nenit 50(1);

s) "garanci ligjore" është një garanci e dhënë në bazë të ligjit të një Shteti Kontraktues që ka bërë një deklaratë në bazë të nenit 39 për të garantuar përmbushjen e një detyrimi, duke përfshirë detyrimin kundrejt një shteti, organi shtetëror apo organizate ndërqeveritare apo private;

t) "njoftimi i një garancie kombëtare" është njoftimi i regjistruar ose që duhet të regjistrohet në Regjistrin Ndërkombëtar që është vendosur një garanci kombëtare;

u) "objekt" është një objekt i një kategorie për të cilin zbatohet neni 2;

v) "garanci ekzistuese" është një garanci e çdo lloji në një objekt e vendosur ose që ka lindur para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas parashikimit të nenit 60(2)(a);

w) "kompensimi" është kompensim në para ose jo para për një objekt që rrjedh nga humbja e tij e plotë ose e pjesshme, ose dëmtimi fizik i objektit apo konfiskimi i tij i plotë apo i pjesshëm, apo shpronësimi i tij.

x) "kalimi i mundshëm i kredisë" është kalimi i kredisë që synohet të bëhet në të ardhmen, me ndodhinë e një ngjarje të caktuar, pavarësisht nëse ndodhja e ngjarjes është e sigurt apo jo;

y) "garanci e mundshme ndërkombëtare" është një garanci që synohet të vendoset apo të parashikohet për një objekt si një garanci ndërkombëtare në të ardhmen, me ndodhinë e një ngjarjeje (e cila mund të jetë edhe përfundimi i garancisë mbi objektin nga debitori) pavarësisht se ndodhja e ngjarjes është e sigurt apo jo;

z) "shitje e mundshme" është një shitje që synohet të bëhet në të ardhmen, me ndodhjen e një ngjarjeje të caktuar, pavarësisht nëse ndodhja e ngjarjes është e sigurt apo jo;

aa) "protokoll" në lidhje me çdo kategori objektësh ose të drejtash të garantuara për të cilat zbatohet kjo Konventë, është protokollin në lidhje me këtë kategori objektësh dhe të drejtash të garantuara;

bb) "i regjistruar" është i regjistruar në Regjistrin Ndërkombëtar në pajtim me kapitullin V;

cc) "garanci e regjistruar" është një garanci ndërkombëtare, një garanci e regjistrueshme apo një garanci kombëtare e përcaktuar në një njoftim të një garancie kombëtare të regjistruar në pajtim me kapitullin V;

- dd) “garanci ligjore e regjistrueshme” është një garanci ligjore e regjistrueshme në vijim të një deklaratë të depozituar në pajtim me nenin 40;
- ee) “Regjistruesi”, në bazë të protokollit, është një person ose organ i caktuar nga ky Protokoll ose emëruar në bazë të nenit 17(2)(b);
- ff) “rregullore” është rregullore e bërë ose e miratuar nga Organi Mbikëqyrës në pajtim me protokollin;
- gg) “shitje” është transferimi i pronësisë mbi një objekt në pajtim me një kontratë shitjeje;
- hh) “detyrim i garantuar” është një detyrim i siguar me një garanci;
- ii) “marrëveshje garancie” është një marrëveshje me anë të së cilës dhënësi i garancisë jep ose bie dakord t’i japë marrësit të garancisë një të drejtë (duke përfshirë të drejtën e pronësisë) në një objekt për të garantuar përmbushje e një detyrimi ekzistues ose të ardhshëm të dhënësit të garancisë apo një personi të tretë;
- jj) “garanci” është një garanci e krijuar me anë të një marrëveshjeje garancie;
- kk) “Organ Mbikëqyrës” në lidhje me protokollin është organi mbikëqyrës i përmendur në nenin 17(1);
- ll) “marrëveshje e rezervimi të titullit” është një marrëveshje për shitjen e në objekti me kusht që pronësia nuk kalon pa u përmbushur kushti ose kushtet e parashikuara në marrëveshje;
- mm) “garanci e paregjistruar” është një garanci e parashikuar në marrëveshje ose ligjore (e ndryshme nga një garanci për të cilën zbatohet neni 39) që nuk është regjistruar, pavarësisht nëse është e regjistrueshme në bazë të kësaj Konvente; dhe
- nn) “me shkrim” është një regjistrim informacioni (duke përfshirë informacionin e komunikuar me teletransmetim) që është në formë fizike apo tjetër dhe mund të riprodhohet në formë fizike në një moment të mëvonshëm dhe tregon me mjete të arsyeshme aprovimin e një personi për këtë regjistrim;

Neni 2

Garancia ndërkombëtare

1. Kjo Konventë parashikon vendosjen dhe efektet e një garancie ndërkombëtare në kategori të ndryshme të pajisjeve të lëvizshme dhe të drejtat e lidhura me to.
2. Për qëllimet e kësaj Konvente një garanci ndërkombëtare në pajisje të lëvizshme është një garanci e vendosur në bazë të nenit 7, në një objekt lehtësisht të identifikueshëm i një kategorie objektesh të tilla që janë renditur në paragrafin 3 dhe përcaktuar në protokoll:
 - a) e dhënë nga dhënësi i garancisë në bazë të një marrëveshjeje garancie;
 - b) që e ka një person i cili është shitësi me kusht në bazë të një marrëveshjeje për rezervimin e titullit; ose
 - c) që e ka një person i cili është dhënësi i lisingut në bazë të një marrëveshjeje lisingu.
 Një garanci që rregullohet nga nënparagrafi (a) nuk rregullohet nga nënparagrafi (b) ose (c).
3. Kategoritë e përmendura në paragrafët e mësipërm janë:
 - a) strukturat e mjeteve të fluturimit, motorët e avionëve dhe helikopterët;
 - b) mjetet lëvizëse hekurudhore; dhe
 - c) vlerat pasurore hapësinore.
4. Ligji i zbatueshëm përcakton nëse një garanci për të cilën, zbatohet paragrafi 2 përfshihet në nënparagrafin (a), (b) apo (c) të këtij nënparagrafi.
5. Një garanci ndërkombëtare në një objekt shtrihet edhe mbi kompensimet që jepen për këtë objekt.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo Konventë zbatohet kur në momentin e lidhjes së marrëveshjes që vendos ose parashikon garancinë ndërkombëtare, debitori ndodhet në një Shtet Kontraktues.
2. Fakti që kreditori ndodhet në një Shtet Jokontraktues nuk cenon zbatueshmërinë e Konventës.

Neni 4

Vendi ku ndodhet debitori

1. Për qëllimet e nenit 3(1), debitori ndodhet në një Shtet Kontraktues;
 - a) në bazë të ligjit të cilit ai është themeluar ose formuar;
 - b) ku ai ka zyrën e regjistruar ose selinë në bazë të statutit;
 - c) ku ai ka qendrën e administratës; ose
 - d) ku ai ka qendrën e aktivitetit.
2. Referenca në nënparagrafin (d) të paragrafit të mësipërm në vendin e aktivitetit të debitorit, nëse ai ka më shumë se një vend aktiviteti, është në vendin kryesor të aktivitetit ose nëse nuk ka vend aktiviteti, në vendbanimin e tij të zakonshëm.

Neni 5

Interpretimi dhe ligji i zbatueshëm

1. Gjatë interpretimit të kësaj Konvente duhet të merren parasysh qëllimet e përcaktuara në preambul, karakteri i saj ndërkombëtar dhe nevoja për të nxitur uniformitetin dhe parashikueshmërinë në zbatimin e saj.

2. Problemet në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë që nuk janë parashikuar shprehimisht në të duhet të rregullohen në pajtim me parimet e përgjithshme mbi të cilat ajo bazohet ose në mungesë të tyre, në pajtim me ligjin e zbatueshëm.

3. Referencat në ligjin e zbatueshëm janë për dispozitat e ligjit të brendshëm që zbatohet në bazë të dispozitave të së drejtës ndërkombëtare private të shtetit të gjendjes gjyqësore.

4. Nëse një shtet përbëhet nga disa njësi territoriale, secila prej të cilave ka dispozitat e veta ligjore në lidhje me çështjen për të cilën duhet të merret vendimi, dhe nuk ka ndonjë tregues për njësinë territoriale përkatëse, ligji i atij shteti vendos se cila është njësi territoriale, dispozitat e të cilës zbatohen. Nëse mungon një rregull i tillë, zbatohet ligji i njësisë territoriale me të cilën çështja është më e lidhur.

Neni 6

Raporti ndërmjet Konventës dhe protokollit

1. Kjo Konventë dhe Protokoll lexohen dhe interpretohen së bashku si një instrument i vetëm.
2. Në rast mospërputhjeje ndërmjet Konventës dhe protokollit, mbizotëron ky i fundit.

KAPITULLI II

KRIJIMI I NJË GARANCIE NDËRKOMBËTARE

Neni 7

Kërkesa formale

Një garanci krijohet si garanci ndërkombëtare në bazë të kësaj Konvente, nëse marrëveshja që krijon ose parashikon garancinë:

- a) është me shkrim;
- b) ka të bëjë me një objekt kompetencën për të disponuar mbi të cilin e ka dhënësi i garancisë, shitësi me kusht ose dhënësi i lisingut;
- c) i mundëson objektit të identifikohet në pajtim me Protokollin; dhe
- d) në rastin e një marrëveshjeje garancie, i mundëson detyrimit të siguruar të caktohet, por pa qenë nevoja të caktohet një shumë ose shumë maksimale e siguruar.

KAPITULLI III

TË DREJTAT NË RAST VONESE

Neni 8

Të drejtat e marrësit të garancisë

1. Në rastin e vonesës së parashikuar në nenin 11, marrësi i garancisë, në masën që dhënësi i garancisë ka rënë dakord në çdo kohë dhe në pajtim me çdo deklaratë që mund të jetë bërë nga një Shtet Kontraktues në bazë të nenit 54, mund të ushtrojë një ose më shumë nga të drejtat e mëposhtme:

- a) merr në posedim ose kontroll çdo objekt që është rënduar në favor të tij;
- b) e shet ose e jep këtë objekt në lising;
- c) arkëton ose merr çdo të ardhur apo fitim që rrjedh nga menaxhimi ose përdorimi i këtij objektit.

2. Marrësi i garancisë mund të bëjë kërkesë për një vendim gjykate që autorizon ose urdhëron një nga veprimet e përmendura në paragrafin e mësipërm.

3. Çdo e drejtë e parashikuar në nënparagrafët (a),(b) ose (c) i paragrafit 1 ose nga neni 13 ushtrohet në një mënyrë të arsyeshme nga pikëpamja ekonomike. Një e drejtë mendohet se ushtrohet në mënyrë të arsyeshme nga pikëpamja ekonomike nëse ajo ushtrohet në pajtim me një dispozitë të marrëveshjes së garancisë, përveç kur një dispozitë e tillë është haptazi e palogjikshme.

4. Një marrës garancie, që propozon të shtesë ose të japë në lising një objekt në pajtim me paragrafin 1, bën një njoftim të arsyeshëm paraprak me shkrim për shitjen ose lisingun e propozuar për:

- a) personat e interesuar të përmendur në nenin 1(m)(i) dhe (ii); dhe
- b) personat e interesuar të përmendur në nenin 1 (m)(iii) që i kanë bërë njoftim marrësit të garancisë për të drejtat e tyre brenda një afati të arsyeshëm para shitjes ose dhënies në lising.

5. Çdo shumë e arkëtuar ose e marrë nga marrësi i garancisë si rezultat i ushtrimit të çdo të drejte të

parashikuar në paragrafin 1 ose 2 shpenzohet për shlyerjen e shumës së detyrimeve të siguruara.

6. Nëse shumat e arkëtuara ose të marra nga marrësi i garancisë si rezultat i ushtrimit të të drejtave të parashikuara në paragrafët 1 ose 2 e tejkalojnë shumën e siguar nga garancia dhe çdo shpenzim të arsyeshëm që është shkaktuar në ushtrimin e kësaj të drejte, atëherë nëse nuk vendoset ndryshe nga gjykata, marrësi i garancisë ua shpërndan vlerën e mbetur poseduesve pasues të garancive që janë regjistruar ose kanë njoftuar marrësin e garancisë, sipas prioritetit dhe ia kthen shumën e mbetur dhënësit të garancisë.

Neni 9

Kalimi i pronësisë mbi objektin për përmbushjen e detyrimit; shlyerja

1. Në çdo kohë pas qenies në vonesë sipas parashikimit në nenin 11, marrësi i garancisë dhe të gjithë personat e interesuar mund të bien dakord që pronësia (dhe çdo garanci tjetër e dhënësit të garancisë) e çdo objekti të rënduar me garanci t'i kalojë marrësit të garancisë për përmbushjen e plotë ose të pjesshme të detyrimit të siguar.

2. Gjykata me kërkesë të marrësit të garancisë mund të vendosë që pronësia (ose çdo garanci tjetër e dhënësit të garancisë) e çdo objekti të rënduar me një garanci t'i kalojë marrësit të garancisë për të përmbushur plotësisht ose pjesërisht detyrimet e siguruara.

3. Gjykata e pranon kërkesën në bazë të paragrafit të mësipërm, vetëm nëse shumat e detyrimeve të siguruara që duhet të përmbushen nëpërmjet këtij kalimi është në raport të arsyeshëm me vlerën e objektit pas llogaritjes së çdo pagese që duhet bërë nga marrësi i garancisë personave të interesuar.

4. Në çdo moment pas qenies në vonesë të parashikuar në nenin 11 dhe para shitjes së objektit të rënduar me barrë ose para marrjes së një vendimi në bazë të paragrafit 2, dhënësi i garancisë ose çdo person i interesuar mund ta shlyejë garancinë duke paguar plotësisht shumën e siguar, duke marrë parasysht çdo marrëdhënie lisingu që mund të jetë lejuar nga marrësi i garancisë në bazë të nenit 8 (1)(b) ose është vendosur në bazë të nenit 8(2). Nëse, pas një qenieje të tillë në vonesë, pagesa e siguar kryhet nga një person i interesuar i ndryshëm nga debitori, atij personi i kalojnë të drejtat e marrësit të garancisë.

5. Pronësia ose çdo e drejtë tjetër e dhënësit të garancisë që kalon nëpërmjet shitjes në bazë të nenit 8 (1)(b) ose në bazë të paragrafit 1 ose 2 të këtij neni është e lirë nga çdo e drejtë tjetër mbi të cilat e drejta e marrësit të garancisë ka prioritet në bazë të dispozitave të nenit 29.

Neni 10

Të drejtat e shitësit me kusht ose dhënësit të lisingut

Në rastin e qenies në vonesë në bazë të një marrëveshjeje për rezervimin e titullit ose një marrëveshjeje lisingu sipas parashikimit të nenit 11, shitësi me kusht ose dhënësi i lisingut, sipas rastit mund:

- a) përveç kur ka një deklaratë që mund të jetë bërë nga një Shtet Kontraktues sipas nenit 54, ta prishë marrëveshjen dhe merr në zotërim ose kontroll çdo objekt që rregullohet nga marrëveshja; ose
- b) të bëjë kërkesë për një vendim gjykatë që autorizon ose vendos një nga këto veprime.

Neni 11

Kuptimi i qenies në vonesë

1. Debitori dhe kreditori mund të bien dakord në çdo kohë me shkrim në lidhje me ngjarjet që përbëjnë qenie në vonesë apo që shërbejnë si shkak për lindjen e të drejtave të parashikuara në nenet 8 deri 10 dhe 13.

2. Nëse debitori dhe kreditori nuk kanë rënë dakord "qenie në vonesë" për qëllimet e neneve 8 deri 10 dhe 13, qenie në vonesë është ajo që i heq të drejtën kreditorit e asaj që ai pretendonte në bazë të marrëveshjes.

Neni 12

Të drejtat e tjera

Çdo e drejtë tjetër e lejuar nga ligji i zbatueshëm duke përfshirë çdo të drejtë për të cilën kanë rënë dakord palët, mund të ushtrohet deri në atë masë që ajo të mos jetë në kundërshtim me dispozitat detyruese të këtij kapitulli sipas parashikimit të nenit 15.

Neni 13

Mbrojtja ligjore e përkohshme

1. Duke marrë parasysht çdo deklaratë që mund të bëjë në bazë të nenit 55, një Shtet Kontraktues siguron që një kreditor, i cili jep prova për qenien në vonesë të debitorit, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar për pretendimin e tij dhe deri në masën që debitori ka rënë dakord në çdo moment, mund të kërkojë

nga gjykata mbrojtje të përkohshme ligjore në formën e një vendimi të mëposhtëm sipas kërkesës së kreditorit:

- a) ruajtjen e objektit dhe vlerës së tij;
- b) zotërimin ose kontrollin e objektit;
- c) lënien të lirë të objektit; dhe

d) lidhjen e një marrëveshjeje lisingu, ose, përveç kur rregullohet nga nënparagrafët (a) deri (c) menaxhimin e objektit dhe e të ardhurave të tij.

2. Në marrjen e një vendimi në bazë të paragrafit të mësipërm, gjykata mund të caktojë ato kushte që i mendon të nevojshme për të mbrojtur personat e interesuar në rast se kreditori:

a) gjatë zbatimit të një vendimi që siguron një mbrojtje të tillë, nuk i përmbush detyrimet e veta kundrejt debitorit në bazë të kësaj Konvente ose të Protokollit;

b) nuk mund të provojë pretendimin pjesërisht ose plotësisht kur merret vendimi përfundimtar për të;

3. Para nxjerrjes së një vendimi në bazë të paragrafit 1, gjykata mund të kërkojë që për kërkesën të vihen në dijeni personat e interesuar.

4. Ky nen nuk cenon zbatimin e nenit 8(3) dhe nuk kufizon format e mbrojtjes së përkohshme të ndryshme nga ato të parashikuara në paragrafin 1.

Neni 14

Kërkesa procedurale

Përveç nenit 54(2), çdo e drejtë e parashikuar në këtë kapitull ushtrohet në pajtim me procedurën e parashikuar nga ligji i vendit ku e drejta duhet të ushtrohet.

Neni 15

Shmangiet

Në marrëdhëniet ndërmjet tyre, dy ose më shumë parë që përmenden në këtë kapitull, në çdo kohë dhe me marrëveshje me shkrim, mund të devijojnë ose të ndryshojnë efektin e çdo dispozite të mësipërme të këtij kapitulli, përveç neneve 8 (3) deri (6), 9(3) dhe (4), 13(2) dhe 14.

KAPITULLI IV

SISTEMI NDËRKOMBËTAR I REGJISTRIMIT

Neni 16

Regjistri Ndërkombëtar

1. Krijohet një Regjistër Ndërkombëtar për regjistrimet e:

a) garancive ndërkombëtare, garancive të mundshme ndërkombëtare dhe të drejtat e ligjshme të regjistrueshme;

b) kalimeve dhe kalimeve të ndryshme të garancive ndërkombëtare;

c) përfitimeve të garancive ndërkombëtare nëpërmjet zëvendësimit ligjor ose ontraktual në bazë të ligjit të zbatueshëm;

d) njoftimeve të garancive kombëtare; dhe

e) ulja në preferencë e garancive të përmendura në secilin prej nënparagrafëve të mësipërm.

2. Regjistra të ndryshëm ndërkombëtarë mund të krijohen për kategori të ndryshme objekteve dhe të drejtave të siguruara.

3. Për qëllimet e këtij kapitulli dhe të kapitulli V, termi “regjistrim” përfshin, sipas rastit, një ndryshim, shtrirje apo fshirje të një regjistrimi.

Neni 17

Organi Mbikëqyrës dhe regjistri

1. Ekziston një Organ Mbikëqyrës sipas parashikimit të Protokollit.

2. Organi Mbikëqyrës:

a) krijon ose merr masa për krijimin e Regjistrimit Ndërkombëtar;

b) përveç kur është parashikuar ndryshe nga protokollin emëron dhe largon nga detyra regjistruesin.

2. Organi Mbikëqyrës:

a) krijon ose merr masa për krijimin e Regjistrimit Ndërkombëtar;

b) përveç kur është parashikuar ndryshe nga protokollin, emëron dhe largon nga detyra regjistruesin;

c) siguron që çdo e drejtë që kërkohet për operimin efektiv të vazhdueshëm të Regjistrimit Ndërkombëtar në rastin e ndryshimit të regjistruesit t’i jepet ose kalojë regjistruesit të ri;

- d) pas konsultimit me Shtete Kontraktuese, bën ose aprovon dhe siguron publikimin e rregulloreve në pajtim me protokollin që kanë të bëjnë me operimin e Regjistrisë Ndërkombëtare;
 - e) cakton procedura administrative nëpërmjet të cilave mund të bëhen ankesat për operimin e Regjistrisë Ndërkombëtare tek Organi Mbikëqyrës;
 - f) mbikëqyr regjistruesin dhe funksionimin e Regjistrisë Ndërkombëtare;
 - g) me kërkesë të regjistruesit, i jep ato udhëzime regjistruesit që Organi Mbikëqyrës i mendon të përshtatshme;
 - h) cakton dhe rishikon periodikisht strukturën e tarifave që caktohen për shërbimet dhe mjetet e Regjistrisë Ndërkombëtare;
 - i) bën gjithçka është e nevojshme për të siguruar që të ekzistojë një sistem regjistrimi elektronik bazuar mbi njoftime për të zbatuar objektivat e kësaj Konvente dhe protokollit; dhe
 - j) u raporton periodikisht Shteteve Kontraktuese në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të veta në bazë të kësaj Konvente dhe Protokollit.
3. Organi Mbikëqyrës mund të lidhë çdo marrëveshje të nevojshme, duke përfshirë një marrëveshje të parashikuar në nenin 27(3).
4. Organi Mbikëqyrës ka të gjitha të drejtat e ligjshme mbi bazat e të dhënave dhe arkivat e Regjistrisë Ndërkombëtare.
5. Regjistruesi siguron funksionimin eficient të Regjistrisë Ndërkombëtare dhe kryen funksionet që i caktohen nga kjo Konventë, protokollin dhe rregulloret.

KAPITULLI V ÇËSHTJE TË TJERA QË LIDHEN ME REGJISTRIMIN

Neni 18

Kërkesat për regjistrim

1. Protokollin dhe rregulloret përcaktojnë kërkesat, duke përfshirë kriteret e identifikimit të objektit:
- a) për kryerjen e një regjistrimi (që përmbledh sigurimin e transmetimit paraprak elektronik të çdo pëlqimi nga çdo person, pëlqimi i të cilëve kërkohet në bazë të nenit 20);
 - b) për kryerjen e kërkimeve dhe lëshimin e vërtetimeve të kërkimeve, dhe mbi bazën e kësaj;
 - c) për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe dokumenteve të Regjistrisë Ndërkombëtare që nuk përfshihen në informacionin dhe dokumentet që kanë të bëjnë me një regjistrim.
2. Regjistruesi nuk ka për detyrë të hetojë nëse është dhënë apo është i vlefshëm një pëlqim për regjistrimin në bazë të nenit 20.
3. Nëse një garanci është regjistruar si një garanci e mundshme ndërkombëtare dhe kjo bëhet garanci ndërkombëtare, nuk kërkohet regjistrim tjetër, me kusht që informacioni i regjistrimit të jetë i mjaftueshëm për regjistrimin e një garancie ndërkombëtare.
4. Regjistruesi merr masa që regjistrimet të përfshihen në bazën e të dhënave të Regjistrisë Ndërkombëtare dhe të jenë të kërkueshme në rend kronologjik sipas hyrjeve, dhe dosja të shënojnë datën dhe kohën e hyrjes.
5. Protokollin mund të parashikojë që një Shtet Kontraktues të caktojë një ose disa zyra në territorin e vet si pikëhyrjeje ose pikahyrjeje nëpërmjet të cilave duhet ose mund t'i transmetohet për regjistrim Regjistrisë Ndërkombëtare informacioni i kërkuar.
- Një Shtet Kontraktues që bën një caktim të tillë mund të përcaktojë kërkesat nëse ka, për t'u përmbushur para se një informacion i tillë t'i transmetohet Regjistrisë Ndërkombëtare.

Neni 19

Vlefshmëria dhe momenti i regjistrimit

1. Një regjistrim është i vlefshëm vetëm nëse bëhet në pajtim me nenin 20.
2. Një regjistrim, nëse është i vlefshëm është i plotë pas futjes së informacionit të kërkuar në bazën e të dhënave të Regjistrisë Ndërkombëtare në mënyrë që të jetë i kërkueshëm.
3. Një regjistrim është i kërkueshëm për qëllimet e paragrafit të mësipërm në momentin kur:
- a) Regjistri Ndërkombëtar i ka caktuar atij një numër serial dosjeje; dhe
 - b) informacioni i regjistrimit, duke përfshirë numrin e dosjes, është ruajtur në formë të qëndrueshme dhe mund të kërkohet në Regjistrinë Ndërkombëtare.
4. Nëse një garanci fillimisht e regjistruar si një garanci e mundshme ndërkombëtare bëhet garanci ndërkombëtare, kjo garanci ndërkombëtare trajtohet sikur të jetë regjistruar nga momenti i regjistrimit të garancisë së mundshme ndërkombëtare, me kusht që regjistrimi të ekzistonte para se të krijohet garancia ndërkombëtare sipas parashikimit të nenit 7.
5. Paragrafi i mësipërm zbatohet me ndryshimet e nevojshme në regjistrimin e një transferimi të

mundshëm të një garancie ndërkombëtare.

6. Një regjistrim është i kërkueshëm në bazën e të dhënave të Regjistrimit Ndërkombëtar në pajtim me kriteret e parashikuara në Protokoll.

Neni 20

Pëlqimi për regjistrimin

1. Një garanci ndërkombëtare, një garanci e mundshme ndërkombëtare ose një transferim apo një transferim i mundshëm i një garancie ndërkombëtare mund të regjistrohet dhe një regjistrim i tillë mund të ndryshohet apo të zgjatet para skadimit, nga secila palë me pëlqimin me shkrim të palës tjetër.

2. Zbritja në rangun e prioritetit të një garancie ndërkombëtare kundrejt një garancie tjetër ndërkombëtare mund të regjistrohet nga ose me pëlqimin me shkrim në çdo kohë të personit, interesi i të cilit ka zbritur në prioritet.

3. Një regjistrim mund të shuhet nga ose me pëlqimin me shkrim të një pale në favor të së cilës është bërë.

4. Përftimi i një garancie ndërkombëtare nëpërmjet kalimit ligjor ose kontraktual të kredisë mund të regjistrohet nga personi që i kalon e drejta.

5. Një e drejtë e regjistrueshme ligjore mund të regjistrohet nga ushtruesi i saj.

6. Një njoftim i një garancie kombëtare mund të regjistrohet nga ushtruesi i saj.

Neni 21

Kohëzgjatja e regjistrimit

Regjistrimi i një garancie ndërkombëtare mbetet në fuqi derisa të fshihet ose skadojë afati i përcaktuar në regjistrim.

Neni 22

Kërkimet

1. Çdo person, në mënyrën e parashikuar nga Protokollin dhe rregulloret, mund të bëjnë ose kërkojnë një kërkim të Regjistrimit Ndërkombëtar me mjete elektronike në lidhje me garancitë ose garancitë e mundshme ndërkombëtare të regjistruara në të.

2. Me marrjen e një kërkesë, regjistruuesi në mënyrën e parashikuar nga protokollin dhe rregulloret, lëshon një certifikatë për kërkimin e regjistrimit me mjetet elektronike në lidhje me çdo objekt:

a) ku tregohet i gjithë informacioni që lidhet me të, së bashku me një deklaratë ku tregohet data dhe ora e regjistrimit të këtij informacioni; ose

b) ku tregohet se nuk ka informacion në Regjistrimin Ndërkombëtar në lidhje me të.

3. Një certifikatë kërkimi e lëshuar në bazë të paragrafit të mësipërm tregon që kreditori i përmendur në informacionin e regjistrimit ka përfutur ose synon të përftojë një garanci ndërkombëtare mbi objektin, por nuk tregon nëse ajo që është regjistruar është një garanci ndërkombëtare apo një garanci e mundshme ndërkombëtare, edhe nëse kjo është e dukshme nga informacioni përkatës i regjistrimit.

Neni 23

Lista e deklarimeve dhe të drejtat ligjore të deklaruara

Regjistruuesi mban një listë të deklarimeve, tërheqjeve të deklarimeve dhe kategorive të drejtave ligjore që i komunikohen regjistrohet nga depozitari dhe deklarohen nga Shtetet Kontraktuese në pajtim me nenet 38 dhe 40, duke vënë datën e secilit prej këtyre deklarimeve ose tërheqjeve të deklarimeve. Kjo listë regjistrohet dhe është e kërkueshme në emrin e shtetit deklarues dhe jepet sipas parashikimit të protokollit dhe rregulloreve çdo personi që e kërkon atë.

Neni 24

Vlera provuese e certifikatave

Një dokument në formën e parashikuar nga rregulloret që duket se është një certifikatë e lëshuar nga Regjistrimi Ndërkombëtar është një provë *prima facie*:

a) që është lëshuar; dhe

b) për faktet e përmendura në të duke përfshirë datën dhe orën e regjistrimit.

Neni 25

Fshirja e regjistrimit

1. Nëse detyrimet e siguruara nëpërmjet një garancie të regjistruar ose detyrimet që kanë shkaktuar një të drejtë ligjore të regjistruar janë përmbushur, apo nëse kushtet për transferimin e titullit në bazë të një marrëveshjeje për rezervimin e titullit janë përmbushur, ushtruesi i kësaj të drejte, pa vonesë, duhet të kërkojë fshirjen e regjistrimit pas kërkesës me shkrim nga debitori të dorëzuar ose marrë në adresën e caktuar në regjistrim.

2. Nëse është regjistruar një garanci e mundshme ndërkombëtare apo një kalim i mundshëm një garancie ndërkombëtare, kreditori i ardhshëm ose cesionari i ardhshëm, pa vonesë, kërkon fshirjen e regjistrimit pas kërkesës me shkrim nga debitori ose cedenti i ardhshëm që dorëzohet ose merret në adresën e caktuar në regjistrim para se kreditori ose cesionari të ketë dhënë vlerën ose të ketë marrë përsipër një detyrim për të dhënë vlerën.

3. Nëse detyrimet e siguruara me një garanci kombëtare të përcaktuara në një njoftim të regjistruar të një garancie kombëtare janë përmbushur, ushtruesi i garancisë pa vonesë, kërkon fshirjen e regjistrimit pas kërkesës me shkrim nga debitori të dorëzuar ose marrë në adresën e caktuar në regjistrim.

4. Nëse një regjistrim nuk duhet të ishte bërë apo është i pasaktë, personi në favorin e të cilit është bërë regjistrimi, pa vonesë kërkon fshirjen ose ndryshimin e tij pas kërkesës me shkrim të debitorit të dorëzuar ose marrë në adresën e treguar në regjistrim.

Neni 26

E drejta për të parë mjetet e regjistrimit ndërkombëtar

Asnjë personi nuk mund t'i mohohet e drejta për të parë mjetet e regjistrimit dhe kërkimit në Regjistrin Ndërkombëtar për asnjë arsye, përveç mosrespektimit të procedurave të parashikuara në këtë Kapitull.

KAPITULLI VI

PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E ORGANIT MBIKËQYRËS DHE REGJISTRUESIT

Neni 27

Personaliteti ligjor; imuniteti

1. Organi Mbikëqyrës merr personalitet ligjor ndërkombëtar nëse nuk e ka pasur këtë personalitet.

2. Organi Mbikëqyrës dhe zyrtarët dhe të punësuarit e tij gëzojnë atë imunitet nga proceset ligjore ose administrative që parashikohet në Protokoll.

3.a) Organi Mbikëqyrës gëzon përjashtim nga taksat dhe privilegje të tjera që mund të parashikohen në marrëveshje me shtetin pritës.

b) Për qëllimet e këtij paragrafi “Shtet pritës” është shteti ku ndodhet Organi Mbikëqyrës.

4. Vlerat pasurore, dokumentet dhe bazat e të dhënave dhe arkivat e Regjistrit Ndërkombëtar janë të paprekshme dhe nuk i nënshtrohen konfiskimit ose proceseve të tjera gjyqësore ose administrative.

5. Për qëllimet e çdo pretendimi kundër regjistruarit në bazë të nenit 28(1) ose nenit 44, pretenduesi ka të drejtën të marrë çdo informacion dhe dokument që është i nevojshëm për t'i dhënë mundësi pretenduesit të ndjekë pretendimin e tij.

6. Organi Mbikëqyrës mund të heqë dorë nga paprekshmëria dhe imuniteti që i jepet nga paragrafi 4.

KAPITULLI VII

PËRGJEGJËSIA E REGJISTRUESIT

Neni 28

Përgjegjësia dhe masat financiare paraprake

1. Regjistruesi përgjigjet për kompensimin e dëmeve për humbjen e pësuar nga një person si pasojë e drejtpërdrejtë e një gabimi ose mosveprimi të regjistruarit dhe zyrtarëve dhe të punësuarve të tij, ose nga një mosfunksionim i sistemit ndërkombëtar të regjistrimit, përveç kur keqfunksionimi shkaktohet nga një ngjarje e një natyre të pashmangshme dhe të pazastueshme, që nuk mund të parandalohet duke përdorur praktikën më të mira duke u përdorur në mënyrë të saktë në fushën e dizenjës dhe operimit të regjistrimit elektronik, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me sigurinë e të dhënave dhe sigurinë e sistemit dhe rrjetit.

2. Regjistruesi nuk mban përgjegjësi në bazë të paragrafit të mësipërm për pasaktësi faktike në informacionin e regjistruar që merret ose jepet nga Regjistruesi në formën që është marrë ai informacion, dhe as

për veprime ose rrethana për të cilat Regjistruesi dhe nëpunësit apo të punësuarit e tij nuk kanë përgjegjësi dhe kanë lindur para marrjes së informacionit të regjistruar në Regjistrin Ndërkombëtar.

3. Kompensimi në bazë të paragrafit 1 mund të zvogëlohet deri në atë masë që personi që ka pësuar dëmin ka shkaktuar ose ka ndikuar në këtë dëm.

4. Regjistruesi duhet të bëjë sigurimin apo garantimin financiar që të mbulojë përgjegjësinë e parashikuar në këtë nen në masën që caktohet nga Organi Mbikëqyrës, në pajtim me Protokollin.

KAPITULLI VIII EFEKTET E NJË GARANCIE NDËRKOMBËTARE KUNDREJT PALËVE TË TRETA

Neni 29

Prioriteti i të drejtave konkurruese

1. Një e drejtë e regjistruar ka prioritet kundrejt çdo të drejte tjetër që regjistrohet më vonë ose kundrejt një të drejte të paregjistruar.

2. Prioriteti i së drejtës së parë në bazë të paragrafit të mësipërm zbatohet:

a) edhe nëse e drejta e parë u përftua ose u regjistrua duke ditur të drejtën tjetër; dhe

b) edhe nëse ushtruesi i së drejtës së parë jep një kundërvleftë duke ditur këtë.

3. Blerësi i një sendi e fiton të drejtën mbi të:

a) duke iu nënshtruar çdo të drejte të regjistruar në momentin e fitimit të saj; dhe

b) të lirë nga çdo e drejtë e paregjistruar edhe nëse ka pasur dijeni për një të drejtë të tillë.

4. Blerësi me kusht ose marrësi i lisingut e fiton të drejtën e tij mbi atë send;

a) duke iu nënshtruar çdo të drejtë të regjistruar para regjistrimit të garancisë ndërkombëtare që ushtrohet nga shitësi ose marrësi i lisingut me kusht; dhe

b) të lirë nga çdo e drejtë që nuk ishte regjistruar në atë moment, edhe nëse ai ka pasuri dijeni faktike për atë të drejtë.

5. Prioriteti i të drejtave konkurruese në bazë të këtij neni mund të ndryshojë me marrëveshje ndërmjet ushtruesve të këtyre të drejtave, por cesionari i një interesi të rangut të ulët nuk është i detyruar të ulë në prioritet të drejtën e tij, përveç kur në momentin e kalimit është regjistruar një ulje në prioritet në lidhje me atë marrëveshje.

6. Çdo prioritet që i jepet një të drejte mbi një send nga ky nen shtrihet edhe në kompensimet për të.

7. Kjo Konventë:

a) nuk cenon të drejtat e një personi në një send, të ndryshëm nga objekti, që ushroheshin para instalimit të tij në objekt, nëse në bazë të ligjit të zbatueshëm këto të drejta vazhdojnë të ekzistojnë pas instalimit; dhe

b) nuk parandalon krijimin e të drejtave në një send, të ndryshëm nga objekti, që është instaluar paraprakisht në një objekt, nëse këto të drejta krijohen në bazë të ligjit të zbatueshëm.

Neni 30

Efektet e falimentimit

1. Në procedurat e falimentimit kundër debitorit një garanci ndërkombëtare ka efekt nëse është regjistruar para fillimit të procedurës së falimentimit në pajtim me këtë Konventë.

2. Ky nen nuk cenon vlefshmërinë e një garancie ndërkombëtare në procedurën e falimentimit nëse kjo garanci është e vlefshme në bazë të ligjit të zbatueshëm.

3. Ky nen cenon:

a) dispozitat ligjore të zbatueshme në procedurat e falimentimit që kanë të bëjnë me mënjanimin e një veprimi juridik që është avantazh ose disavantazh për kreditorët;

b) dispozitat procedurale që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave mbi pronën që është në kontrollin dhe mbikëqyrjen e administratorit të falimentimit.

KAPITULLI IX KALIMI I TË DREJTAVE TË SIGURUARA DHE GARANCIVE NDËRKOMBËTARE, TË DREJTAT NGA KALIMI I KREDISË

Neni 31

Efektet e transferimit

1. Përveç kur palët bien dakord ndryshe, kalimi i të drejtave të siguruara bërë në pajtim me nenin 32, i kalon cesionarit edhe:

a) garancisë ndërkombëtare përkatëse; dhe

b) të gjitha të drejtat dhe prioritetet e cedentit në bazë të kësaj Konvente.

2. Kjo Konventë nuk parandalon transferimin e pjesshëm të drejtave të siguruara të cedentit. Në rastin e transferimit të pjesshëm, cedenti dhe cesionari mund të bien dakord për të drejtat e tyre përkatëse në lidhje me garancinë ndërkombëtare të transferuar në bazë të paragrafit të mësipërm, por që nuk mund të kenë efekt negativ mbi debitorin pa pëlqimin e tij.

3. Në bazë të paragrafit 4, ligji i zbatueshëm përcakton prapësimet dhe të drejtat e kompensimit të debitorit kundrejt cesionarit.

4. Debitori mund të heqë dorë nga çdo kohë me marrëveshje nga të gjitha ose disa prapësime dhe të drejtat e kompensimit të përmendura në paragrafin e mësipërm, përveç prapësimeve që rrjedhin nga veprimet mashtruese nga ana e cesionarit.

5. Në rastin e një transferimi me anë të garancisë, të drejtat e siguruara që transferohen i rikthehen cedentit, në atë masë që ato ekzistojnë akoma, pasi të jenë shlyer detyrimet e siguruara nëpërmjet transferimit.

Neni 32

Kërkesat formale të transferimit

1. Me transferimin e të drejtave të siguruara transferohet edhe garancia ndërkombëtare vetëm nëse transferimi:

- a) bëhet me shkrim;
- b) mundëson identifikimin e të drejtave të siguruara në bazë të kontratës nga e cila ato rrjedhin; dhe
- c) në rastin e një transferimi me anë të garancisë, mundëson që detyrimet e siguruara nga transferimi të përcaktohen në pajtim me Protokollin, por pa qenë nevoja të caktohet një shumë ose një shumë maksimale e siguar.

2. Transferimi i një garancie ndërkombëtare të krijuar ose parashikuar në një marrëveshje garancie nuk është e vlefshme, përveç kur transferohen disa ose të gjitha të drejtat e tjera të siguruara të lidhura me të.

3. Kjo Konventë nuk zbatohet për transferimin e të drejtave të siguruara i cili nuk realizon edhe transferimin e garancisë përkatëse ndërkombëtare.

Neni 33

Detyrimet e debitorit kundrejt cesionarit

1. Në masën që të drejtat e siguruara dhe garancia ndërkombëtare e lidhur me to janë transferuar në pajtim me nenet 31 dhe 32, debitori në lidhje me këto të drejta dhe këtë garanci detyrohet nga transferimi dhe ka për detyrë t'i bëjë pagesa ose përmbushë detyrimet të tjera cesionarit, nëse dhe vetëm kur:

- a) debitori është njoftuar me shkrim në lidhje me transferimin nga cedenti ose me autorizimin e tij; dhe
- b) njoftimi identifikon të drejtat e siguruara.

2. Pavarësisht nga ndonjë shkak tjetër nga i cili pagesa ose përmbushja e detyrimit nga debitori e liron këtë të fundit nga detyrimi, pagesa ose shlyerja e detyrimit është e vlefshëm për këtë qëllim vetëm nëse bëhet në pajtim me paragrafin e mësipërm.

3. Ky nen nuk cenon prioritetin e transferimeve konkurruese.

Neni 34

Të drejtat në rast vonese në lidhje me transferimin e siguar

Në rastin e qenies në vonesë të cedentit në bazë të transferimit të siguar të të drejtave të siguruara dhe garancisë përkatëse ndërkombëtare, nenet 8, 9 dhe 11 deri në 14 zbatohen në marrëdhëniet ndërmjet cedentit dhe cesionarit (dhe, në lidhje me të drejtat e siguruara, zbatohen deri në atë masë që këto dispozita mund të zbatohen për pasurinë e patrupëzuar), sikur referencat:

a) në detyrimin e siguar dhe garancinë të ishin referenca në detyrimin e siguar nëpërmjet transferimit të të drejtave të siguruara dhe garancisë përkatëse ndërkombëtare, dhe garancinë e krijuar nëpërmjet këtij transferimi;

b) tek marrësi i garancisë ose kreditori dhe dhënësi i garancisë ose debitori të ishin referenca tek cesionari dhe cedenti;

c) tek ushtruesi i garancisë ndërkombëtare të ishin referenca tek cesionari; dhe

d) tek objekti të ishin referenca tek të drejtat e siguruara të transferuara dhe tek garancia përkatëse ndërkombëtare.

Neni 35

Prioriteti i transferimeve konkurruese

1. Nëse ka transferime konkurruese të të drejtave të siguruara dhe të paktën një prej transferimeve përfshin një garanci ndërkombëtare dhe kjo është e regjistruar, dispozitat e nenit 29 zbatohen sikur referencat tek

një garanci e regjistruar të ishin referencat tek një transferim i të drejtave të siguruara dhe tek garancia përkatëse e regjistruar, dhe sikur referencat tek një garanci e regjistruar ose e paregjistruar të ishin referenca tek një transferim i regjistruar apo i paregjistruar.

2. Neni 30 zbatohet për një transferim të të drejtave të siguruara sikur referencat në një garanci ndërkombëtare të ishin referenca tek një transferim i të drejtave të siguruara dhe garancisë ndërkombëtare përkatëse.

Neni 36

Prioriteti i cesionarit në lidhje me të drejtat e siguruara

1. Cesionari i të drejtave të siguruara dhe garancisë përkatëse ndërkombëtare transferimi i të cilit është regjistruar ka prioritet në bazë të nenit 35(1) mbi cesionarët e tjerë me të drejta të siguruara:

a) nëse kontrata në bazë të së cilës të drejtat e siguruara kanë lindur parashikon që ato janë garantuar me anë të objektit ose kanë të bëjnë me të; dhe

b) në masën që të drejtat e siguruara kanë të bëjnë me objektin.

2. Për qëllimet e nënparagrafit (b) të paragrafit të mësipërm, të drejtat e siguruara kanë të bëjnë me një objekt vetëm në masën që ato përbëhen nga të drejta pagese ose përmbushje detyrimesh që kanë të bëjnë:

a) me një shumë të paradhënë dhe të përdorur për blerjen e objektit;

b) me një shumë të parapaguar dhe të përdorur për blerjen e një objekti tjetër në të cilin cedenti ushtronte një garanci ndërkombëtare nëse cedenti ia ka transferuar këtë garanci cesionarit dhe transferimi është regjistruar.

c) me çmimin që paguhet për objektin;

d) me qiranë e lisingut që paguhet për objektin; ose

e) me detyrime të tjera që rrjedhin nga një transaksion të përmendur në ndonjë nga nënparagrafët e mësipërm.

3. Në të gjitha rastet e tjera, prioriteti i transferimeve konkurruese i të drejtave të siguruara përcaktohet nga ligji i zbatueshëm.

Neni 37

Efektet e paaftësisë paguese të cedentit

Dispozitat e nenit 30 zbatohen për procedurat e falimentimit kundër cedentit sikur referencat tek debitori të ishin referenca tek cedenti.

Neni 38

Kalimi i kredisë

1. Në pajtim me paragrafin 2, kjo Konventë nuk cenon përfitimim e të drejtave të siguruara dhe garancinë përkatëse ndërkombëtare nëpërmjet kalimit ligjor ose kontraktual të kredisë në bazë të ligjit të zbatueshëm.

2. Prioriteti ndërmjet çdo të drejte sipas parashikimit të paragrafit të mësipërm dhe një interesi konkurrues mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet ushtruesve të të drejtave përkatëse, por një cesionar i një interesi të rangut të ulët nuk detyrohet nga kjo marrëveshje për të ulur në prioritet të drejtën e tij, përveç kur në momentin e transferimit është regjistruar ulja në preferencë në lidhje me këtë marrëveshje.

KAPITULLI X

TË DREJTAT NË BAZË TË DEKLARATAVE TË SHTETEVE KONTRAKTUESE

Neni 39

Të drejtat që kanë prioritet pa u regjistruar

1. Një Shtet Kontraktues mund të deklarojë në çdo kohë, nëpërmjet një deklarate të depozituar tek depozitari i protokollit, përgjithësisht ose veçanërisht:

a) ato kategori të drejtash ligjore (të ndryshme nga e drejta ku zbatohet neni 40 të cilat sipas ligjit të atij shteti kanë prioritet kundrejt në të drejte mbi një send të njëjtë me atë të ushtruesit të garancisë ndërkombëtare të regjistruar dhe që kanë prioritet kundrejt një garancie ndërkombëtare të regjistruar, qoftë brenda apo jashtë procedurës së falimentimit; dhe

b) që kjo Konventë nuk cenon të drejtën e një shteti apo organi shtetëror, organizatë ndërkombëtare apo ofruesi privat të shërbimeve publike për të siguruar dhe mbajtur një objekt në bazë të ligjeve të atij shteti për shkak të pagesës së shumave që i detyrohet këtij organi, organizate apo ofruesi shërbimesh që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ato shërbime në lidhje me atë objekt apo një tjetër.

2. Një deklaratë e bërë në bazë të paragrafit të mësipërm mund të shprehet për të mbuluar kategoritë që janë krijuar pas depozitimit të asaj deklaratë.

3. Një e drejtë ligjore ka prioritet kundrejt një garancie ndërkombëtare, nëse dhe vetëm kur ajo është brenda një kategorie që mbulohet nga një deklaratë e depozituar para regjistrimit të garancisë ndërkombëtare.

4. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, një Shtet Kontraktues, në momentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit në protokoll, mund të deklarojë që një e drejtë e një kategorie të mbuluar nga një deklaratë e bërë sipas nënparagrafit (a) të paragrafit 1 ka prioritet kundrejt një garancie ndërkombëtare të regjistruar para datës së këtij ratifikimi, pranimi, aprovimi apo aderimi.

Neni 40

Të drejtat e regjistrueshme ligjore

Një Shtet Kontraktues, në çdo kohë dhe me deklaratë me shkrim të depozituar tek depozitari i protokollit, mund të rendisë kategoritë e të drejtave ligjore që janë të regjistrueshme në bazë të kësaj Konvente në lidhje me çdo kategori të objektit sikur e drejta të ishte një garanci ndërkombëtare dhe rregullohet përkatësisht. Një deklaratë e tillë ndryshohet në çdo kohë.

KAPITULLI XI

ZBATIMI I KONVENTËS PËR SHITJET

Neni 41

Shitja dhe shitja e mundshme

Kjo Konventë zbatohet për shitjen ose shitjet e mundshme të një objekti sipas parashikimit në Protokoll me çdo ndryshim të mundshëm në të.

KAPITULLI XII

JURIDIKSIONI

Neni 42

Zgjedhja e gjendjes gjyqësore

1. Në bazë të neneve 43 dhe 44, gjykatat e një Shteti Kontraktues të zgjedhura nga palët në një veprim juridik kanë juridiksion në lidhje me çdo pretendim të ngritur në bazë të kësaj Konvente, pavarësisht nëse gjendja gjyqësore e zgjedhur ka lidhje me palët apo veprimin juridik. Ky juridiksion është përjashtues, përveç kur palët bien dakord ndryshe.

2. Një marrëveshje e tillë është me shkrim apo në një mënyrë tjetër në pajtim me kërkesat formale të ligjit të gjendjes gjyqësore të zgjedhur.

Neni 43

Juridiksioni në bazë të nenit 13

1. Gjykatat e një Shteti Kontraktues të zgjedhura nga Palët dhe gjykatat e Shtetit Kontraktues mbi territorin e të cilit ndodhet objekti kanë juridiksion për të dhënë mbrojtje ligjore në bazë të nenit 13 (1) (a),(b),(c) dhe nenit 13 (4) në lidhje me këtë objekt.

2. Juridiksioni për të dhënë mbrojtje ligjore në bazë të nenit 13(1) (d) apo mbrojtje të përkohshme ligjore në bazë të nenit 13(4) mund të ushtrohet:

a) nga gjykatat e zgjedhura nga palët;ose

b) nga gjykatat e një Shteti Kontraktues në territorin e të cilit ndodhet debitori, duke qenë në mbrojtje që, sipas kushteve të vendimit që e jep këtë, është e ekzekutueshme vetëm në territorin e atij Shteti Kontraktues.

3. Një gjykatë ka juridiksion në bazë të paragrafëve të mësipërm, edhe nëse vendimi përfundimtar për pretendimin e përmendur në nenin 13(1) do të ose mund të merret në një gjykatë të një Shteti tjetër Kontraktues ose me arbitrazh.

Neni 44

Juridiksioni për nxjerrjen e vendimeve kundër regjistruesit

1. Gjykata e vendit ku Regjistruesi ka qendrën e administrimit kanë juridiksion përjashtues për të caktuar kompensimin ose të marrë vendime kundër regjistruesit.

2. Nëse një person nuk përmbush një kërkesë në bazë të nenit 25 dhe personi ka pushuar së ekzistuari

apo nuk mund të gjendet për të mundësuar një vendim kundër tij që të kërkojë fshirjen e regjistrimit, gjykatat e përmendura në paragrafin e mësipërm kanë juridiksion përjashtues, me kërkesë të debitorit ose debitorit të mundshëm, për të nxjerrë një vendim drejtuar regjistruesisit që i kërkon regjistruesisit të fshijë regjistrimin.

3. Nëse një person nuk përmbush në vendim të një gjykate që ka juridiksion në bazë të kësaj Konvente apo në rastin e një garancie kombëtare, një vendim të një gjykate që ka juridiksion kompetent t'i kërkojë këtij personi të kërkojë ndryshimin apo fshirjen e një regjistrimi, gjykatat e përmendura në paragrafin 1 mund t'i kërkojnë regjistruesisit të ndërmarrë ato hapa që do të mundësojë atë vendim.

4. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafët e mësipërm, asnjë gjykatë nuk mund të nxjerrë vendime përfundimtare apo të ndërmjetme kundër apo që detyrojnë regjistruesisin.

Neni 45

Juridiksioni në procedurat e falimentimit

Dispozitat e këtij kapitulli nuk zbatohen për procedurat e falimentimit.

KAPITULLI XIII

RAPORTI ME KONVENTAT E TJERA

Neni 45 bis

Raporti me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Transferimin e Kredisë në Tregtinë Ndërkombëtare

Kjo Konventë mbizotëron mbi Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi transferimin e kredisë në Tregtinë Ndërkombëtare, të hapur për nënshkrim në Nju Jork më 12 dhjetor 2001, pasi ajo ka të bëjë me transferimin e kredive që janë të drejtat e siguruar në lidhje me garancitë ndërkombëtare në objektet e mjeteve të fluturimit, mjeteve të lëvizshme të hekurudhave dhe vlerave pasurore hapësinore.

Neni 46

Raporti me Konventën UNIDROIT mbi lisingun financiar ndërkombëtar

Protokolli mund të përcaktojë raportin ndërmjet kësaj Konvente dhe Konventës UNIDROIT mbi lisingun financiar ndërkombëtar, të nënshkruar në Otavë, më 28 maj 1988.

KAPITULLI XIV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 47

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim në Cape Town, më 16 nëntor 2001 nga shtetet që marrin pjesë në Konferencën Diplomatike për miratimin e një Konvente për pajisjet e lëvizshme dhe një protokoll për mjetet e fluturimit të mbajtur në Cape Town nga 29 tetori deri më 16 nëntor 2001. Pas 16 nëntorit 2001, Konventa është e hapur për të gjithë shtetet për nënshkrim në qendrën e Institutit Ndërkombëtar për Unifikimin e të Drejtës Private (UNIDROIT) në Romë, derisa të hyjë në fuqi në pajtim me nenin 49.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo aprovimit nga shtetet që e kanë nënshkruar atë.

3. Çdo Shtet që nuk e nënshkruan këtë Konventë mund të aderojë në të në çdo kohë.

4. Ratifikimi, pranimi, aprovimi apo aderimi kryhet duke depozituar për këtë qëllim instrumentin formal tek depozitari.

Neni 48

Organizatat Rajonale të Integritit Ekonomik

1. Një Organizatë Rajonale e Integritit Ekonomik, që përbëhet nga shtete sovraane dhe ka kompetencë mbi çështje të caktuara të rregulluara nga kjo Konventë, mund të nënshkruajë, pranojë, aprovojë apo aderojë gjithashtu në këtë Konventë. Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik në këtë rast ka të drejtat dhe detyrimet e një Shteti Kontraktues, në masën që organizata ka kompetencë për çështjet e rregulluara nga kjo Konventë. Nëse numri i Shteteve Kontraktuese është i vlefshëm në këtë Konventë, Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik nuk llogaritet si një Shtet Kontraktues së bashku me shtetet e veta anëtare që janë Shtete Kontraktuese.

2. Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik, në momentin e nënshkrimit, pranimit, aprovimit apo aderimit, i bën një deklaratë depozitarit që përcakton çështjet e rregulluara në këtë Konventë në lidhje me të cilat

kompetenca i është transferuar organizatës nga shtetet e veta anëtare. Organizata Rajonale e Integritimit Ekonomik njofton menjëherë depozitarin në lidhje me çdo ndryshim për shpërndarjen e kompetencës, duke përfshirë transferimet e reja të kompetencës, të parashikuara në deklaratën sipas këtij paragrafi.

3. Çdo referencë në një “Shtet Kontraktues” apo “Shtete Kontraktuese” apo “Shtet Palë” apo “Shtete Palë” në këtë Konventë zbatohet po ashtu për një Organizatë Rajonale të Integritimit Ekonomik nëse kjo kërkohet nga konteksti.

Neni 49

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të tre muajve nga data e depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit, por vetëm në lidhje me kategoritë e objekteve për të cilat zbatohet një Protokoll:

- a) nga momenti i hyrjes në fuqi të protokollit përkatës;
- b) në pajtim me kushtet e këtij protokoll; dhe
- c) ndërmjet Shteteve Palë në këtë Konventë dhe protokollit përkatës.

2. Për Shtete e tjera kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të tre muajve pas datës së depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, por vetëm në lidhje me kategoritë e objekteve për të cilat zbatohet një protokoll dhe, në lidhje me këtë protokoll, në pajtim me kushtet e nënparagrafëve (a), (b) dhe (c) të paragrafit të mësipërm.

Neni 50

Veprimet juridike të brendshme

1. Një Shtet Kontraktues në momentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit dhe aderimit në protokoll, mund të deklarojë që kjo Konventë nuk zbatohet për një veprim juridik që është një veprim juridik i brendshëm në lidhje me atë shtet për të gjitha llojet e objekteve ose disa prej tyre.

2. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, dispozitat e neneve 8(4), 9(1), 16 kapitulli V, neni 29 dhe çdo dispozitë e kësaj Konvente në lidhje me garancitë e regjistruara zbatohen për një veprim juridik të brendshëm.

3. Nëse njoftimi për një garanci kombëtare është regjistruar në Regjistrin Ndërkombëtar, prioriteti i ushtruesit të kësaj garancie në bazë të nenit 29 nuk cenohet nga fakti që kjo garanci i është kaluar një personi tjetër nëpërmjet transferimit apo kalimit në bazë të ligjit të zbatueshëm.

Neni 51

Protokollet e ardhshme

1. Depozitari mund të krijojë grupe pune në bashkëpunim me ato organizata joqeveritare që depozitari i konsideron të përshtatshme për të vlerësuar fizibilitetin e zgjerimit të Konventës, nëpërmjet një ose disa protokolleve, në objekte të çdo kategorie të pajisjeve të lëvizshme të një vlere të lartë, të ndryshme nga një kategori e përmendur në nenin 2(3), çdo anëtar i së cilës është lehtësisht i identifikueshëm, dhe të drejtat e siguruar në lidhje me këto objekte.

2. Depozitari u komunikon tekstin e çdo projektprotokollit paraprak në lidhje me një kategori të objekteve të përgatitura nga një grup pune i tillë të gjitha Shteteve Palë në këtë Konventë, të gjitha shteteve anëtare të depozitarit, shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, që nuk janë anëtare të depozitarit dhe organizatave përkatëse ndërqeveritare, dhe i fton këto shtete dhe organizata të marrin pjesë në bisedime ndërqeveritare për përfundimin e një projektprotokollit mbi bazën e një projektprotokollit të tillë.

3. Depozitari ua komunikon tekstin e çdo projektprotokollit paraprak të përgatitur nga një grup pune i tillë edhe atyre organizatave joqeveritare që depozitari i konsideron të përshtatshme. Këto organizata ndërqeveritare ftohen të paraqesin menjëherë komentet mbi tekstin e projektprotokollit paraprak tek depozitari dhe të marrin pjesë si vëzhgues në përgatitjen e projektprotokollit.

4. Nëse organet kompetente të depozitarit mendojnë se një projektprotokoll është i përshtatshëm për miratim, Depozitari thërret një konferencë diplomatike për miratimin e tij.

5. Menjëherë pas miratimit të këtij protokollit, në pajtim me paragrafin 6, kjo Konventë zbatohet për kategorinë e objekteve që rregullohen prej tij.

6. Neni 45 bis i kësaj Konvente zbatohet për një protokoll të tillë vetëm nëse kjo është e parashikuar shprehimisht në atë protokoll.

Neni 52

Njësitë territoriale

1. Nëse një Shtet Kontraktues ka njësi territoriale ku zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai, në momentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, mund të deklarojë që kjo Konventë shtrihet në të gjitha njësitë territoriale apo vetëm në një apo disa prej tyre, dhe mund të ndryshojë deklaratën e tij duke paraqitur në çdo kohë një deklaratë tjetër.

2. Një deklaratë e tillë parashikon shprehimisht njësitë territoriale ku zbatohet kjo Konventë.

3. Nëse një Shtet Kontraktues nuk ka bërë një deklaratë në bazë të paragrafit 1, kjo Konventë zbatohet në të gjitha njësitë territoriale të atij shteti.

4. Nëse një Shtet Kontraktues e shtrin këtë Konventë në një apo disa njësi territoriale, deklaratat e lejuara në bazë të kësaj Konvente mund të bëhen në lidhje me çdo njësi territoriale të tillë, dhe deklaratat e bëra në lidhje me një njësi territoriale mund të jetë e ndryshme nga ato të bëra në lidhje me një njësi tjetër territoriale.

5. Nëse në sajë të një deklaratë në bazë të paragrafit 1, kjo Konventë shtrihet në një apo disa njësi territoriale të një Shteti Kontraktues:

a) debitori konsiderohet të ndodhet në një Shtet Kontraktues vetëm nëse është themeluar apo formuar në bazë të një ligji në fuqi në një njësi territoriale në të cilën zbatohet kjo Konventë, apo që ka zyrën e regjistruar apo qendrën statutore, qendrën e administrimit, vendin e aktivitetit apo vendbanimin e zakonshëm në një njësi territoriale ku zbatohet kjo Konventë;

b) çdo referencë në vendndodhjen e një objekti në një Shtet Kontraktues i referohet vendndodhjes së objektit në një njësi territoriale në të cilën zbatohet kjo Konventë, dhe

c) çdo referencë tek autoritetet administrative në atë Shtet Kontraktues interpretohet sikur t'u referohet organeve administrative që kanë juridiksion në një njësi territoriale ku zbatohet kjo Konventë.

Neni 53

Përcaktimi i gjykatave

Një Shtet Kontraktues, në momentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit në protokoll, mund të deklarojë “gjykatën” apo “gjykatat” përkatëse për qëllimet e nenit 1 të kapitullit 12 të kësaj Konvente.

Neni 54

Deklarimet mbi të drejtat në rast mospërbushje detyrimi

1. Një Shtet Kontraktues, në momentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit në protokoll, mund të deklarojë që derisa objekti i rënduar me barrë është në të apo kontrollohet nga territori i tij, marrësi i garancisë nuk mund të japë në lising objektin brenda atij territori.

2. Një Shtet Kontraktues, në momentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit në protokoll mund të deklarojë nëse ndonjë nga të drejtat në rast mospërbushjeje detyrimi që në bazë të dispozitave të kësaj Konvente nuk është parashikuar vënia në lëvizje e gjykatës, mund të ushtrohet nga kreditori vetëm me lejen e gjykatës.

Neni 55

Deklarimet për mbrojtje ligjore në pritje të vendimit përfundimtar

Një Shtet Kontraktues në momentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit në Protokoll, mund të deklarojë që ai nuk i zbaton dispozitat e nenit 13 ose nenit 43, ose të dyja, pjesërisht ose plotësisht. Deklarimi përcakton në cilat kushte zbatohet neni përkatës, nëse zbatohet pjesërisht, apo cilat forma të tjera të ndihmës së përkohshme zbatohen.

Neni 56

Rezervat dhe deklaratimet

1. Nuk mund të bëhet asnjë rezervë për këtë Konventë përveç deklaratimeve të aturizuara nga nenet 39,40,50,52,54,55,57,58 dhe 60 në pajtim me këto dispozita.

2. Çdo deklaram apo deklarim i mëvonshëm apo çdo tërheqje e një deklarimi të bërë në bazë të kësaj Konvente i njoftohet me shkrim Depozitarit.

Neni 57

Deklarimet e mëvonshme

1. Një Shtet Palë mund të bëjë një deklarim të mëvonshëm, të ndryshëm nga deklarimi i autorizuar në bazë të nenit 60, në çdo kohë pas datës në të cilën kjo Konventë ka hyrë në fuqi për të, duke njoftuar për këtë qëllim Depozitarin.

2. Çdo deklaram i tillë i mëvonshëm hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të gjashtë muajve pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari. Nëse për hyrjen në fuqi të deklaramit është parashikuar një afat më i gjatë në njoftim, ai hyn në fuqi me kalimin e këtij afati më të gjatë pas marrjes së njoftimit nga Depozitari.

3. Pavarësisht nga paragrafët e mësipërm, kjo Konventë vazhdon të zbatohet sikur të mos ishte bërë asnjë deklaram i mëvonshëm, në lidhje me të gjitha të drejtat e lindura para datës së hyrjes në fuqi të deklarimeve të mëvonshme.

Neni 58

Tërheqja e deklarimeve

1. Çdo Shtet Palë që ka bërë një deklaram në lidhje me këtë Konventë, të ndryshme nga një deklaram i autorizuar në bazë të nenit 60, mund ta tërheqë atë në çdo kohë duke njoftuar Depozitarin. Kjo tërheqje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të gjashtë muajve pas datës së njoftimit nga Depozitari.

2. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, kjo Konventë vazhdon të zbatohet, sikur të mos ishte bërë tërheqje e deklaramit, në lidhje me të gjitha të drejtat e lindura para datës së hyrjes në fuqi të tërheqjes.

Neni 59

Denoncimet

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar me shkrim Depozitarin.

2. Çdo denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të dymbëdhjetë muajve pas datës në të cilën njoftimi merret nga Depozitari.

3. Pavarësisht nga paragrafët e mësipërm, kjo Konventë vazhdon të zbatohet, sikur të mos ishte bërë asnjë denoncim, në lidhje me të gjitha të drejtat që kanë lindur para datës së hyrjes në fuqi të një njoftimi të tillë.

Neni 60

Dispozita tranzitore

1. Nëse nuk deklarohet ndryshe në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, Konventa nuk zbatohet për një të drejtë ekzistuese që ruan prioritetin që kishte në bazë të ligjit të zbatueshëm para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e nenit 1(v) dhe prioriteti përcaktues në bazë të kësaj Konvente:

a) "data e hyrjes në fuqi e kësaj Konvente" në lidhje me një debitor është momenti kur kjo Konventë hyn në fuqi ose momenti kur shteti në të cilin ndodhet debitori bëhet një Shtet Kontraktues, në varësi se cila ndodh më vonë; dhe

b) debitori ndodhet në shtetin ku ai ka qendrën e administratës ose, nëse nuk ka qendër administrate, vendin e aktivitetit, ose, nëse ai ka më shumë se një vend aktiviteti, vendin kryesor të aktivitetit, ose nëse nuk ka vend aktiviteti, vendbanimin e tij të zakonshëm.

3. Një Shtet Kontraktues, në deklaramin e tij në bazë të paragrafit 1, mund të caktojë një datë, jo më parë se tre vjet pas datës në të cilën deklarata hyn në fuqi, kur kjo Konventë dhe protokoll bëhen të zbatueshëm, për qëllimin e caktimit të prioritetit, duke përfshirë mbrojtjen e çdo prioriteti ekzistues, për të drejtat ekzistuese apo garancitë që lindin në bazë të një marrëveshjeje të bërë në një moment kur debitori ndodhej në një shtet të përmendur në nënparagrafin (b) të paragrafit të mësipërm, por vetëm në masën dhe mënyrën e përcaktuar në deklaramtë.

Neni 61

Konferencat rishikuese, ndryshimet dhe çështjet e lidhura me ta

1. Depozitari përgatit raporte vjetore ose në intervale të tilla që mund të kërkohen nga rrethanat për Shtetet Palë në lidhje me mënyrën në të cilën kuadri i rregullave ndërkombëtare të parashikuara nga kjo Konventë është zbatuar në praktikë. Gjatë përgatitjes së raporteve të tilla, depozitari merr parasysh raportet e organit mbikëqyrës në lidhje me funksionimin e sistemit ndërkombëtar të regjistrimit.

2. Me kërkesë të jo më pak se njëzet e pesë për qind e Shteteve Palë, konferencat rishikuese të Shteteve Palë thirren periodikisht nga Depozitari, në konsultim me Organin Mbikëqyrës, për të shqyrtuar;

a) zbatimin praktik të kësaj Konvente dhe efektivitetin e saj për të lehtësuar financimin e bazuar mbi vlera pasurore dhe lisingun e objekteve që rregullohen nga dispozitat e saj;

b) interpretimin gjyqësor të, dhe zbatimin e bërë për dispozitat, aktivitetin e regjistruarit dhe mbikëqyrjen e ushtruar nga organi mbikëqyrës, duke marrë parasysh raportet e Organit Mbikëqyrës; dhe

d) nëse janë të nevojshme ndryshime në Konventë ose rregullat në lidhje me Regjistrin Ndërkombëtar.

3. Në bazë të paragrafit 4, çdo ndryshim i kësaj Konvente aporovohet nga të paktën një shumicë prej dy të tretave të Shteteve Palë që marrin pjesë në Konferencën që përmendet në paragrafin e mësipërm dhe pastaj

hyri në fuqi në lidhje me shtetet që kanë ratifikuar, pranuar, ose aprovuar këtë ndryshim, pasi të jetë ratifikuar, pranuar ose aprovuar nga tre shtete në pajtim me dispozitat e nenit 49 në lidhje me hyrjen e saj në fuqi.

4. Nëse ndryshimi i propozuar për këtë Konventë mendohet të zbatohet në më shumë se një kategori pajisjesh, ky ndryshim aprovohet gjithashtu nga një shumicë prej të paktën dy të tretat e Shteteve Palë në çdo Protokoll që marrin pjesë në Konferencën e përmendur në paragrafin 2.

Neni 62

Depozitari dhe funksionet e tij

1. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit depozitohen në Institutin Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private (UNIDROIT), që këtu emërohet Depozitues.

2. Depozitari:

a) informon të gjitha Shtetet Kontraktuese për:

i) çdo nënshkrim ose depozitim të ri të një instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi, së bashku me datën e tij;

ii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;

iii) çdo deklaratë të bërë në pajtim me këtë Konventë, së bashku me datën e saj;

iv) tërheqjen ose ndryshimin e çdo deklaratë, së bashku me datën e saj; dhe

v) njoftimin e çdo denoncimi të kësaj Konvente së bashku me datën e saj dhe datën në të cilën hyn në fuqi;

b) u transmeton kopje të vërtetuara të kësaj Konvente të gjitha Shteteve Kontraktues;

c) i jep Organit Mbikëqyrës dhe regjistruesit kopje të çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi apo aderimi, së bashku me datën e depozitimit të tyre, të çdo deklaratë apo tërheqje apo ndryshimi të një deklaratë dhe çdo njoftimi denoncimi, së bashku me datën e njoftimit të tyre, në mënyrë që informacioni që përmbahet në to të bëhet i ditur lehtësisht dhe plotësisht; dhe

d) kryhen edhe funksione të tjera që janë të zakonshme për depozitarin.

Si dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Cape Town, më 16 nëntor, 2001 në një kopje të vetme në gjuhën angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle; të gjitha tekstet janë njëllëj autentike; ky autencitet hyn në fuqi me verifikimin nga Sekretariati i përbashkët i Konferencës nën autoritetin e Presidentit të Konferencës brenda nëntëdhjetë ditëve duke filluar nga kjo datë, në lidhje me përputhshmërinë e teksteve me njëri-tjetrin.

PROTOKOLL I KONVENTËS

MBI GARANCITË NDËRKOMBËTARE NË PAJISJET E LËVIZSHME NË LIDHJE ME ÇËSHTJE SPECIFIKE PËR PAJISJET E MJETEVE TË FLUTURIMIT

Shtetet Palë në këtë Protokoll,

duke u konsideruar të nevojshëm zbatimin e konventës mbi Garancitë Ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme (tani e tutje e njohur si Konventa”), që lidhjet me pajisje të mjeteve të fluturimit, duke marrë parasysh qëllimet e përcaktuara në preambulën e Konventës;

të vetëdijshëm për nevojën për të përshtatur Konventën që të plotësojë kërkesat e veçanta të financimit të mjeteve të fluturimit dhe për të zgjeruar fushën e zbatimit të Konventës që të përfshijë kontratat e shitjes së pajisjeve të mjeteve të fluturimit;

duke pasur parasysh parimet dhe objektivat e Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, të nënshkruar në Çikago, më 7 dhjetor 1944,

bien dakord për dispozitat e mëposhtme në lidhje me pajisjet e mjeteve të fluturimit.

KAPITULLI I

FUSHA E ZBATIMIT DHE DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimi i termave

1. Termat e përdorur në këtë Protokoll janë përdorur sipas kuptimit të përcaktuar në Konventë, përveç rasteve kur konteksti e parashikon ndryshe.

2. Në këtë Protokoll termat e mëposhtëm janë përdorur me kuptimet e përcaktuara më poshtë:

a) “mjet fluturimi” është mjet fluturimi ashtu si përkufizohet për qëllimet e Konventës së Çikagos, që mund të jenë struktura të mjeteve të fluturimit ku instalohen motorët e një aeroplani, ose helikopterë;

b) “motor të avionit” janë motorë të avionit (ndryshe nga ato që përdoren në shërbimet ushtarake, doganore apo policore) që punojnë me anë të forcës shtytëse reaktive, teknologjisë së turbinave apo pistonave

dhe:

i) në rastin e motorëve të aeroplanëve me forcë shtytëse reaktive kanë të paktën 1750 Ib forcë shtytëse ose një vlerë ekuivalente;dhe

ii) në rastin e motorëve të aeroplanëve që punojnë me turbinë apo pistonë, që në fazën e ngritjes kanë një shtytje nominale prej të paktën 550 kuaj fuqi ose vlerën ekuivalente, së bashku me të gjitha modulet dhe aksesorët e tjerë të instaluar, të përfshirë apo të fiksuar, pjesët, pajisjet dhe të gjitha të dhënat, manualët dhe regjistrimet në lidhje me to;

c) “objekt i mjeteve të fluturimit” është strukturë e mjeteve të fluturimit, motorë avioni dhe helikopterë;

d) “regjistër i mjeteve të fluturimit” është regjistër që mbahet nga një Shtet ose një organ i përbashkët i regjistrimit të markave për qëllimet e Konventës së Çikagos;

e) “struktura të mjeteve të fluturimit janë struktura të mjeteve të fluturimit (ndryshe nga ato që përdoren në shërbimet ushtarake, doganore apo policore), të cilat kur në to instalohen motorët e duhur të aeroplanëve, janë modele të certifikuar nga autoriteti kompetent i aviacionit për të transportuar:

i) të paktën (8) persona përfshirë ekuipazhin, ose

ii) mallra më shumë se 2750 kilogram, së bashku me të gjithë aksesorët e instaluar, të përfshirë apo fiksuar, pjesët dhe pajisjet (përveç motorëve të aeroplanit) dhe të gjitha të dhënat, manualët dhe regjistrimet në lidhje me to;

f) “pala e autorizuar” është pala e referuar në nenin XIII (3);

g) “Konventa e Çikagos” është Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar e nënshkruar në Çikago më 7 dhjetor 1944, e ndryshuar, dhe anekset e saj;

h) “organi i përbashkët për regjistrimin e markave” është autoriteti që mban një regjistër në përputhje me nenin 77 të Konventës së Çikagos, ashtu siç zbatohet nga Rezoluta në lidhje me kombësinë dhe regjistrimin e mjeteve të fluturimit të drejtuara nga agjenci ndërkombëtare, e miratuar më 14 dhjetor 1967 nga Këshilli i Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar;

i) “çregjistrimi i mjetit të fluturimit” është fshirja ose heqja e regjistrimit të mjetit të fluturimit nga regjistri i mjeteve të fluturimit në përputhje me Konventën e Çikagos;

j) “kontratë e garancisë” është kontrata e nënshkruar nga një person në cilësinë e garantit;

k) “garant” është një person që, për të siguruar kryerjen e çdo detyrimi në favor të një kreditori të siguar nga një marrëveshje garancie ose sipas një marrëveshjeje, merr përsipër një dorëzani ose jep një garanci një *standby letter of credit* ose ndonjë formë tjetër të sigurimit të kredisë;

l) “helikopterë” janë pajisje më të rënda se ajri (ndryshe nga ato që përdoren për shërbime ushtarake, doganore apo policore) qëndrimi në fluturim i të cilave sigurohet kryesisht nga kundërveprimi i ajrit në një apo më shumë rotorë në boshte vertikale dhe që janë certifikuar nga autoriteti kompetent i aviacionit për të transportuar:

i) të paktën (5) persona përfshirë këtu ekuipazhin; ose

ii) mallra më shumë se 450 kilogram së bashku me të gjithë aksesorët e instaluar, të përfshirë apo të fiksuar, pjesët dhe pajisjet (përveç rotorëve) dhe të gjitha të dhënat, manualët dhe regjistrimet në lidhje me to;

m) “situata e paaftësisë paguese” është:

i) fillimi i procedurës së falimentimit; ose

ii) qëllimi i deklaruar i debitorit për të pezulluar pagesat apo pezullimi aktual i tyre kur ligji apo një masë tjetër e Shtetit e ndalon apo e pezullon të drejtën e kreditorit për të filluar procedurën e falimentimit kundër debitorit ose për të ushtruar të drejta sipas Konventës;

n) “juridiksioni fillestar i falimentimit” tregon Shtetin Kontraktues ku ndodhet qendra e garancive kryesore të debitorit, e cila për këtë qëllim dhe në raset se nuk parashikohet ndryshe, konsiderohet si vendi ku debitori ka vendin e ligjshëm, ose nëse kjo nuk ekziston, si vendi ku debitori është përfshirë;

o) “autoriteti i regjistrimit” tregon autoritetin kombëtar ose autoritetin e ngarkuar me mbajtjen e një regjistri për mjetet e fluturimit në një Shtet Kontraktues dhe përgjegjës për regjistrimin dhe çregjistrimin e një mjeti fluturimi në përputhje me Konventën e Çikagos; dhe

p) “shteti i regjistrimit” në lidhje me një mjet fluturimi është shteti në regjistrin kombëtar të të cilit është regjistruar një mjet fluturimi ose shteti i vendndodhjes së autoritetit të ngarkuar me mbajtjen e një regjistri të mjeteve të fluturimit.

Neni 2

Zbatimi i Konventës në lidhje me objektet e mjeteve të fluturimit

1. Konventa zbatohet në lidhje me objektet e materialeve të fluturimit ashtu si parashikohet nga kushtet e këtij Protokoll.

2. Konventa dhe ky protokoll njihen si Konventa mbi Garancitë Ndërkombëtare në Pajisjet e lëvizshme ndërsa zbatohet për objektet e mjeteve të fluturimit.

Neni 3

Zbatimi i Konventës për kontratat e shitjeve

Dispozitat e mëposhtme të Konventës zbatohen sikur referencat për një marrëveshje që krijon ose parashikon një garanci ndërkombëtare të ishin referenca të një kontrate shitjeje dhe sikur referencat për një garanci ndërkombëtare, një garanci të mundshme ndërkombëtare, për debitorin dhe kreditorin të ishin përkatësisht referenca të një shitjeje, të një shitjeje të mundshme, të shitësit dhe blerësit;

Neni 3 dhe 4;

Neni 16(1)(a);

Neni 19(4);

Neni 20(1) në lidhje me regjistrimin e një kontrate shitjeje ose shitjeje të mundshme);

Neni 25(2) (në lidhje me një shitje të mundshme); dhe

Neni 30

Përveç kësaj, dispozitat e përgjithshme të nenit 1, nenit 5, kapitujve IV deri në VII, nenit 29 (përveç nenit 29 (3) që zëvendësohet nga neni XIV (1) dhe (2), kapitullit X, kapitullit XII (përveç nenit 43, kapitullit XIII dhe kapitullit XIV (përveç nenit 60) zbatohen për kontratat e shitjeve dhe shitjeve të mundshme).

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Pa paragjykuar nenin 3(1) të Konventës, Konventa zbatohet gjithashtu në lidhje me një helikopter ose një strukturë të mjeteve të fluturimit që bën pjesë në një mjet fluturimi, të regjistruar në një regjistër të mjeteve të fluturimit të një Shteti Kontraktues që është Shteti i Regjistrimit; kur ky regjistrim është bërë sipas një marrëveshjeje për regjistrimin e një mjeti fluturimi ai konsiderohet në fuqi në kohën e marrëveshjes.

2. Për qëllim të përkufizimit të “veprimi juridik të brendshëm” në nenin 1 të Konventës:

a) një strukturë e mjeteve të fluturimit ndodhet në shtetin e regjistrimit të mjetit të fluturimit ku bën pjesë;

b) një motor avioni ndodhet në shtetin e regjistrimit të mjetit të fluturimit ku është instaluar apo, nëse nuk është instaluar në mjetin e fluturimit, atje ku ndodhet fizikisht; dhe

c) një helikopter ndodhet në shtetin e regjistrimit, në kohën e përfundimit të marrëveshjes që krijon ose parashikon garancinë;

3. Palët, në marrëveshje me shkrim, mund të përjashtojnë zbatimin e nenit XI dhe në marrëdhëniet e tyre me njëra-tjetrën mund të shmangin ose të ndryshojnë ndikimin e dispozitave të këtij protokollit përveç nenit IX (2)-(4).

Neni 5

Formalitetet, efektet dhe regjistrimi i kontratave të shitjes

1. Për qëllimet e këtij Protokollit, një kontratë shitjeje është ajo që:

a) është me shkrim;

b) ka të bëjë me një objekt të mjeteve të fluturimit të cilën shitësi ka kompetencë ta shesë; dhe

c) mundëson që objekti i mjeteve të fluturimit të identifikohet në përputhje me këtë Protokoll.

2. Një kontratë shitjeje i transferon blerësit të drejtat e shitësit mbi objektin e mjetit të fluturimit sipas kushteve të vetë kontratës.

3. Regjistrimi i një kontrate shitjeje mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar. Regjistrimi i një shitjeje të mundshme mbetet në fuqi nëse nuk fshihet, ose në të kundërt, deri në përfundim të periudhës së përcaktuar në regjistër.

Neni 6

Kapacitetet përfaqësuese

Një person mund të përfundojë një marrëveshje ose shitje dhe të regjistrojë një garanci ndërkombëtare, ose një shitje në lidhje me një objekt të mjeteve të fluturimit në cilësinë e të autorizuarit, të një agjencie apo të një përfaqësuesi tjetër. Në këtë rast, ky person ka të drejtën të mbrojë të drejtat dhe garancitë sipas Konventës.

Neni 7

Përshkrimi i objekteve të mjeteve të fluturimit

Një përshkrim i objektit të mjeteve të fluturimit që përmban numrin serial të prodhuesit, emrin e prodhuesit dhe emërtimin e modelit është i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të identifikuar objektin për qëllimet

e nenit 7c të Konventës dhe nenit V(1) c të këtij protokollit.

Neni 8

Zgjedhja e ligjit të zbatueshëm

1. Ky nen zbatohet vetëm kur një Shteti Kontraktues ka bërë një deklaratë sipas nenit XXX(1).
2. Palët e një marrëveshjeje, të një kontratë shitjeje, të një kontrate garancie apo të një marrëveshjeje për ulje në prioritet mund të bien dakord mbi ligjin që do të rregullojë të drejtat dhe detyrimet e tyre kontraktuale, tërësisht ose pjesërisht.
3. Përveç rastet kur bien dakord ndryshe, referenca në paragrafin e mësipërm për këtë ligj të zgjedhur nga palët tregon të drejtën kombëtare të Shtetit të përcaktuar ose, në rast se ky Shtet përfshin njësi të ndryshme territoriale, të drejtën kombëtare të njësisë së përcaktuar territoriale.

KAPITULLI II

TË DREJTAT NË RAST VONESE, PËRPARËSITË DHE KALIMET E KREDISË

Neni 9

Ndryshim i dispozitave në lidhje me të drejtat në rast vonesë

1. Përveç të drejtave të parashikuara në kapitullin III të Konventës, kreditori për aq sa debitori, në çdo kohë dhe në rrethanat e përcaktuara në kapitullin III ka rënë dakord:
 - a) mund të bëjë çregjistrimin e mjetit të fluturimit; dhe
 - b) mund të sigurojë eksportin dhe transferimin fizik të objektit të mjeteve të fluturimit nga territori ku ndodhet.
2. Kreditori nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin e mësipërm pa pëlqimin paraprak me shkrim të ushtruesit të një të drejte të regjistruar që ndryshon në përparësi me atë të kreditorit.
3. Neni 8(3) i Konventës nuk zbatohet për objekte të mjeteve të fluturimit. Çdo e drejtë e parashikuar në Konventë në lidhje me një objekt të mjeteve të fluturimit duhet të ushtrohet në mënyrë të arsyeshme nga pikëpamja ekonomike. Një e drejtë do të konsiderohet e ushtruar në mënyrë të arsyeshme nga pikëpamja ekonomike kur është ushtruar në përputhje me një dispozitë një Marrëveshjes, përveç rastit kur kjo dispozitë është haptazi e palogjikshme.
4. Një marrës garancie që u bën peronave të interesuar një njoftim me shkrim, dhjetë ose më shumë ditë pune më përpara për një propozim për shitje ose hua konsiderohet se plotëson kërkesat për të siguruar “njoftim të arsyeshëm paraprak”, të parashikuar në nenin 8(4) të Konventës. Paragrafi i mësipërm nuk e ndalon një marrës garancie dhe një dhënës garancie ose garant të bien dakord për një periudhë më të gjatë për njoftim paraprak.
5. Autoriteti i regjistrimit në një Shtet Kontraktues, për të zbatuar çdo ligj dhe rregullore në lidhje me sigurinë, e pranon një kërkesë për çregjistrim dhe eksport nëse:
 - a) kërkesa paraqitet në formën e duhur nga një palë e autorizuar sipas një autorizimi të pakthyeshëm të regjistruar të çregjistrimit e të kërkesës për eksport; dhe
 - b) pala e autorizuar i vërteton autoritetin të regjistrimit, nëse ky i fundit e kërkon, që të gjitha garancitë e regjistruara që renditen në përparësi mbi ato të kreditorit në favor të të cilit është nxjerrë autorizimi janë fshirë ose që ushtruesit e këtyre garancive kanë dhënë pëlqimin për çregjistrimin dhe eksportin.
6. Një marrës garancie që propozon çregjistrimin dhe eksportin e një mjeti fluturimi sipas paragrafit 1 dhe në zbatim të një urdhri gjykate duhet të bëjë paraprakisht një njoftim të arsyeshëm me shkrim për çregjistrimin dhe eksportin e të propozuar për:
 - a) personat e interesuar të përcaktuar në nenin 1(m) (1) dhe (ii) të Konventës; dhe
 - b) personat e interesuar të përcaktuar në nenin 1(m) (iii) të Konventës që e kanë njoftuar marrësin e garancisë për të drejtat e tyre me një njoftim të arsyeshëm përpara çregjistrimit dhe eksportit.

Neni 10

Ndryshimi i dispozitave në lidhje me mbrojtje ligjore të përkohshme

1. Ky nen zbatohet vetëm kur një Shtet Kontraktues ka bërë një deklaratë sipas nenit 30(2) dhe për fushën e veprimit të përcaktuar në këtë deklaratë.
2. Për qëllimet e nenit 13(1) të Konventës në kontekstin e marrjes së masave shprehja “e përkohshme” duhet të kuptohet si numri i ditëve të punës nga data e paraqitjes së kërkesës së përcaktuar në deklaratën e bërë nga Shteti kontraktues ku është paraqitur kërkesa.
3. Neni 13(1) i Konventës zbatohet duke shtuar dispozitën e mëposhtme menjëherë pas paragrafit “d”:

“e) shitjen dhe përdorimin e fitimit të ardhur prej saj, nëse në çdo kohë debitori dhe kreditori bien dakord në mënyrë specifike”

Dhe nenin 43(2) zbatohet duke shtuar fjalët “dhe (e)” pas fjalëve “neni 13(1)(d)”.

4. E drejta e pronësisë ose një e drejtë tjetër e debitorit e kaluar për efekt të shitjes të përmendur në paragrafin e mësipërm është e çliruar nga çdo e drejtë tjetër mbi të cilin garancia ndërkombëtare e kreditorit ka përparësi sipas dispozitave të nenit 29 të Konventës.

5. Kreditori dhe debitori ose ndonjë person tjetër i interesuar mund të bien dakord me shkrim të përjashtojnë zbatimin e nenit 13(2) të Konventës.

6. Në lidhje me të drejtat në nenin 9(1):

a) në një Shtet Kontraktues vihen në dispozicion nga autoriteti i regjistrimit dhe autoritete të tjera administrative, sipas rastit, jo më vonë se 5 ditë pune nga data kur kreditori ka njoftuar këto autoritete që mbrojtja e parashikuar në nenin 9(1) është ushtruar, ose në rast se mbrojtja është dhënë nga një gjykatë e huaj, e njohur nga një gjykatë e Shtetit Kontraktues, dhe që kreditori është i autorizuar të ushtrojë të drejtat në përputhje me Konventën; dhe

b) autoritetet kompetente bashkëpunojnë menjëherë dhe ndihmojnë kreditorin në ushtrimin e këtyre të drejtave në përputhje me zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fushën e sigurimit ajror.

7. Paragrafët 2 dhe 6 nuk paragjykojnë ligjet apo rregulloret e zbatueshme për fushën e sigurisë ajrore.

Neni 11

Të drejtat në rastin e paaftësisë paguese

1. Ky nen zbatohet vetëm kur një Shtet kontraktues që është juridiksioni fillestar i falimentimit ka bërë një deklaratë sipas nenit 30(3).

Alternativa A

2. Në rastin e një paaftësie paguese sipas paragrafit 7, administratori i falimentimit ose debitori, sipas rastit, i kthen kreditorit objektin e mjeteve të fluturimit jo më vonë se fillimi i dy datave të mëposhtme:

a) fundi i periudhës së pritjes; dhe

b) data kur kreditori ka të drejtën të marrë në zotërim objektin e mjeteve të fluturimit nëse ky nen nuk do të zbatohet.

3. Për qëllime të këtij neni “koha e pritjes” është periudha e përcaktuar në një deklaratë të Shtetit Kontraktues që është juridiksioni fillestar i falimentimit.

4. Referenca në këtë nen për “administratorin e falimentimit” nënkuptojnë personin në cilësinë e tij zyrtarë, jo personale.

5. Derisa kreditori nuk ka pasur mundësi të marrë në zotërim objektin sipas paragrafit 2:

a) administratori i falimentimit ose debitori, sipas rastit, e ruajnë dhe kujdesen për objektin e mjeteve të fluturimit dhe e ruajnë vlerën e tij në përputhje me marrëveshjen; dhe

b) kreditori gëzon të drejtën të kërkojë që të vihet në dispozicion çdo mbrojtje tjetër e përkohshme sipas ligjit të zbatueshëm.

6. Nënparagrafi (a) i paragrafit 5 nuk ndalon përdorimin e objektit të mjeteve të fluturimit sipas rregullimeve të përcaktuara për t'u kujdesur për objektin dhe për të ruajtur vlerën e tij.

7. Administratori i falimentimit ose debitori, sipas rastit, mund të vazhdojnë të mbajnë në zotërim objektin e mjeteve të fluturimit, kur sa më larg datës së përcaktuar në paragrafin 2, kanë rregulluar të gjitha shkeljet, ndryshe nga ato janë krijuar me fillimin e procedurës së falimentimit, dhe kanë rënë dakord të përmbushin të gjitha detyrimet e ardhshme sipas Marrëveshjes. Një periudhë e dytë pritjeje nuk zbatohet në rastin e mospërmbushjes së detyrimeve në të ardhmen,

8. Në lidhje me të drejtat e parashikuara në nenin 9(1):

a) në një Shtet Kontraktues duhen të vihen në dispozicion nga autoriteti i regjistrimit dhe autoritete të tjera administrative, sipas rastit jo më vonë se 5 ditë pune nga data kur kreditori ka njoftuar këto autoritete që është i autorizuar të ushtrojë të drejta të tilla në përputhje me Konventën dhe

b) autoritetet kompetente bashkëpunojnë menjëherë dhe ndihmojnë kreditorin në marrjen e këtyre masave në përputhje me zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fushën e sigurimit ajror.

9. Ushtrimi i të drejtave të lejuara nga Konventa ose ky protokoll pas datës së treguar në paragrafin 2 nuk mund të pengohet apo të vonohet.

10. Asnjë detyrim i debitorit sipas Marrëveshjes nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e kreditorit.

11. Asnjë depozitë në paragrafin e mësipërm nuk mund të interpretohet për të paragjykuar autoritetin e administratorit të falimentimit, nëse ndodh, për të zgjidhur një marrëveshje sipas ligjit të zbatueshëm.

12. Asnjë e drejtë, përveç të drejtave ligjore të pakushtëzuara të një kategorie që mbulohet nga një deklaratë e bërë në zbatim të nenit 39(1) nuk ka epërsi mbi të drejtat e regjistruara në procedurën e falimentimit.

13. Konventa e ndryshuar me nenin 9 të këtij protokollit zbatohet për ushtrimin e çdo të drejte sipas këtij neni.

Alternativa B

2. Në rastin e një falimentimi, administratori i falimentimit ose debitori, sipas rastit, duhet të njoftojë kreditorin, me kërkesë të tij, brenda kohës së përcaktuar në një deklaratë të një Shteti Kontraktues të bërë në zbatim të nenit 30(3) nëse do të:

a) rregullojë të gjitha shkeljet ndryshe nga ato që janë krijuar në fillimin e procedurës së falimentimit dhe nëse do të bjerë dakord për të përmbushur detyrimet e ardhshme, sipas marrëveshjes dhe dokumenteve të lidhura me të; ose nëse

b) do t'i japë kreditorit mundësinë të marrë në përdorim objektin e mjeteve të fluturimit në përputhje me të ligjin e zbatueshëm.

3. Ligji i zbatueshëm i përmendur në nënparagrafin (b) të paragrafit të mëparshëm mund të autorizojë gjykatën të marrë masa të tjera ose të parashikojë garanci të tjera shtesë.

4. Kreditori siguron prova të pretendimit të tij dhe justifikim të regjistrimit të garancisë ndërkombëtare.

5. Nëse administratori i falimentimit ose debitori, sipas rastit, nuk njofton kreditorin në përputhje me paragrafin 2, ose nëse administratori i falimentimit ose debitori, edhe pse ka deklaruar që do t'i japë kreditorit mundësinë të marrë në përdorim objektin e mjeteve të fluturimit nuk vepron kështu, gjykata mund të autorizojë kreditorin të marrë në përdorim objektin sipas kushteve të caktuara nga gjykata, si dhe mund të kërkojë të merren masa shtesë apo të sigurohen garanci shtesë.

6. Objekti i mjeteve të fluturimit nuk shitet në pritje të vendimit të gjykatës në lidhje me kredinë dhe garancinë ndërkombëtare.

Neni 12

Ndihma në rast falimentimi

1. Ky nen zbatohet vetëm kur një Shtet Kontraktues ka bërë një deklaratë sipas nenit 30(1).

2. Gjykatat e një Shteti Kontraktues ku ndodhet objekti, në përputhje me të drejtën e Shtetit Kontraktues bashkëpunojnë maksimalisht me gjykatat e huaja dhe administratorët e huaj të falimentimit për të zbatuar dispozitat e nenit 11.

Neni 13

Autorizimi i kërkesës për çregjistrim dhe shkelje për eksport

1. Ky nen zbatohet vetëm kur një Shtet kontraktues ka bërë një deklaratë sipas nenit 30(1).

2. Nëse debitori ka lëshuar një autorizim të pakthyeshëm të kërkesës për çregjistrim dhe lejë eksporti në përputhje me formularin në aneksin e këtij protokollit dhe e ka paraqitur këtë për regjistrim tek autoriteti i regjistrimit, ky autorizim regjistrohet si i tillë.

3. Personi në favor të të cilit është lëshuar autorizimi (pala e autorizuar) ose personi që është caktuar në të, është personi i vetëm që gëzon të drejtën të ushtrijë të drejtat e parashikuara në nenin 9(1). Ushtrimi i këtyre të drejtave duhet të bëhet në përputhje me autorizimin dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme në fushën e sigurisë ajrore. Ky autorizim nuk mund të shfuqizohet nga debitori për miratimin me shkrim të palës së autorizuar. Autoriteti i regjistrimit bën regjistrimin e një autorizimi nga regjistri pas kërkesës nga pala e autorizuar.

4. Autoriteti i regjistrimit dhe autoritetet të tjera administrative në Shtetet Kontraktuese bashkëpunojnë menjëherë dhe ndihmojnë palën e autorizuar në ushtrimin e të drejtave të parashikuara në nenin 9.

Neni 14

Ndryshimi i dispozitave që rregullojnë përparësinë

1. Blerësi i një objekti të mjeteve të fluturimit sipas një shitjeje të regjistruar fiton të drejtën e tij mbi atë objekt të lirë nga çdo e drejtë e regjistruar në vijim dhe nga çdo e drejtë e paregjistruar, edhe nëse ai është në dijeni të së drejtës së paregjistruar.

2. Blerësi i një objekti të mjeteve të fluturimit sipas një shitjeje të regjistruar fiton të drejtën e tij mbi atë objekt sipas një të drejte të regjistruar në kohën e blerjes.

3. E drejta e pronësisë, një e drejtë tjetër mbi motorin e një avionit nuk preket nga fakti që është instaluar në apo që është hequr nga një avion.

4. Neni 29(7) i Konventës zbatohet për një objekt, që nuk është objekt sipas kuptimit të këtij protokollit, të instaluar në strukturën enjë mjeti fluturimi, në motorin e avionit apo në helikopter.

Neni 15

Ndryshimi i dispozitave të kalimit të kreditit

Neni 33(1) i Konventës zbatohet duke shtuar dispozitën e mëposhtme menjëherë pas nënparagrafit (b):

“dhe (c) debitori ka dhënë pëlqimin me shkrim, pavarësisht nga rrethana që ky miratim është dhënë përpara verifikimit të dorëzimit apo identifikimit të cesionarit”.

Neni 16

Dispozitat në lidhje me debitorin

1. Në rastin e mosqenies në vonesë, sipas kuptimit të nenit 11 të Konventës, debitori gëzon të drejtën e mbajtjes dhe përdorimit të objektit në përputhje me marrëveshjen kundrejt:

a) kreditorit vetë dhe ushtruesit të ndonjë të drejte nga i cili debitori fiton të drejta të lira sipas nenit 29(4) dhe Konventës ose, në cilësinë e blerësit, sipas nenit 14(1) të këtij protokoll, në rast se dhe për aq sa debitori nuk ka rënë dakord ndryshe; dhe

b) ushtruesit të ndonjë të drejte, të cilit i nënshtrohet e drejta e debitorit sipas nenit 29(4) të Konventës, ose në cilësinë e blerësit sipas nenit 14(2) të këtij protokoll, por vetën për aq sa ku ushtrues ka rënë dakord.

2. Asnjë dispozitë në Konventë apo në këtë Protokoll nuk e prek përgjegjësinë e një kreditori për çdo shkelje të Marrëveshjes sipas ligjit të zbatueshëm për sa kohë që kjo Marrëveshje ka të bëjë me një objekt të mjeteve të fluturimit.

KAPITULLI III

DISPOZITAT MBI SISTEMET E REGJISTRIMIT TË GARANCIVE NDËRKOMBËTARE NË LIDHJE ME OBJEKTET E MJETEVE TË FLUTURIMIT

Neni 17

Organi regjistrues dhe regjistruesi

1. Organi mbikëqyrës është njësi ndërkombëtare e caktuar me një rezolutë të miratuar nga konferenca diplomatike për të miratuar një Konventë në lidhje me pajisjet e lëvizshme dhe një protokoll për mjetet e fluturimit.

2. Nëse njësi ndërkombëtare e përmendur në paragrafin e mësipërm nuk është në gjendje dhe e gatshme të veprojë si organ mbikëqyrës, mblihet një konferencë e shteteve nënshkruese dhe kontraktuese për të caktuar një organ tjetër mbikëqyrës.

3. Organi mbikëqyrës, zyrtarët e nëpunësit e tij gëzojnë imunitet nga procesi ligjor dhe administrativ, ashtu si parashikohet në rregullat e zbatueshme për ta si një njësi ndërkombëtare apo me titull tjetër.

4. Organi mbikëqyrës mund të krijojë një komision ekspertësh, midis disa personave të emëruar nga shtetet nënshkruese dhe kontraktuese që kanë kualifikimin dhe përvojën e nevojshme dhe t'i besojnë atij detyrën për të ndihmuar organin mbikëqyrës në kryerjen e funksioneve të tij.

5. Regjistruesi i parë siguron funksionimin e Regjistrimit Ndërkombëtar për një periudhë 5-vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokoll. Më pas, Regjistruesi emërohet ose riemërohet me mandat të rregullt 5-vjeçar nga organi mbikëqyrës.

Neni 18

Rregullorja e parë

Rregullorja e parë e bërë nga organi mbikëqyrës hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll.

Neni 12

Caktimi i pikave të hyrjes

1. Sipas paragrafit 2, një Shtet Kontraktues në çdo kohë, mund të caktojë në territorin e tij një apo disa organizma si pikë apo pika hyrjeje përmes të cilave do t'i transmetohet apo mund t'i transmetohet Regjistrimit Ndërkombëtar informacioni i nevojshëm për regjistrimin, përveç regjistrimit të një njoftimi të një të drejte apo të drejte kombëtare sipas nenit 40, në secilin rast, që del sipas ligjeve të një shteti tjetër.

2. Caktimi i bërë sipas paragrafit të mësipërm mund të lejojë, por jo të detyrojë përdorimin e një ose disa pikave të caktuara të hyrjes për informacionin e nevojshëm për regjistrimin në lidhje me motorët e avionëve.

Neni 20

Ndryshimet shtesë të dispozitave në lidhje me Regjistrin

1. Për qëllimet e nenit 19(6) të Konventës, kriteret e kërkimit të objektit të mjeteve të fluturimit janë emri i prodhuesit, numri serial i prodhuesit, dhe emërtimi i modelit, të nevojshme për të siguruar origjinalitetin. Ky informacion shtesë përcaktohet në rregullore.

2. Për qëllimet e nenit 25(2) të Konventës dhe në rrethanat e përshkruara në të, ushtruesi i një garancie

të mundshme ndërkombëtare të regjistruar ose të një kalimi të mundshëm të një garancie ndërkombëtare të regjistruar ose personi në favor të të cilit është regjistruar një shitje e mundshme duhet të marrë masat në dispozicion të tij për të siguruar çregjistrimin jo më vonë se pesë ditë pune pas marrjes së kërkesës të përcaktuar në këtë paragraf.

3. Tarifat e përmendura në nenin 17(2)(h) të Konventës përcaktohen që të mbulojnë koston e arsyeshme të krijimit, operimit dhe rregullimit të regjistrimit ndërkombëtar dhe koston e arsyeshme të organit mbikëqyrës në lidhje me ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave, dhe me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenin 17(2) të Konventës.

4. Regjistruesi ushtron dhe administron funksionet e centralizuara të regjistrimit ndërkombëtar gjatë 24 orëve. Pikat e ndryshme të hyrjeve punojnë të paktën gjatë orëve të punës në territoret e tyre përkatëse.

5. Shuma e siguracionit apo e garancisë financiare e përmendur në nenin 28(4) të Konventës, në lidhje me çdo ngjarje nuk është pak se vlera maksimale e një objekti të mjeteve të fluturimit, ashtu siç përcaktohet nga organi mbikëqyrës.

6. Asnjë dispozitë në Konventë nuk e ndalon Regjistruesin të gjejë një siguracion apo garanci financiare që mbulon ngjarjet për të cilat vetë Regjistruesi nuk është përgjegjës sipas nenit 28 të Konventës.

KAPITULLI IV JURIDIKSIONI

Neni 21

Ndryshimi i dispozitave në lidhje me juridiksionin

Për qëllimet e nenit 43 të Konventës dhe sipas nenit 42 të Konventës, një gjykatë e një Shteti kontraktues gjithashtu ka juridiksion kur objekti është një helikopter ose një strukturë e mjeteve të fluturimit që bën, për të cilën shteti në fjalë, është shteti i regjistrimit.

Neni 22

Dorëheqja nga imuniteti i juridiksionit

1. Sipas paragrafit 2, dorëheqja e imunitetit sovran nga juridiksioni i gjykatave të përcaktuara në nenin 42 ose nenin 43 të Konventës ose në lidhje me ushtrimin e të drejtave mbi një objekt të mjeteve të fluturimit sipas Konventës, është e detyrueshme, dhe nëse janë plotësuar kushtet e tjera për këtë juridiksion apo ushtrim, ajo është e zbatueshme sipas rastit për të deleguar juridiksionin dhe për të lejuar zbatimin e dreheqjes.

2. Dorëheqja sipas paragrafit të mësipërm, duhet të bëhet me shkrim dhe të përmbajë një përshkrim të objektit të mjeteve të fluturimit.

KAPITULLI V RAPORTI ME KONVENTA TË TJERA

Neni 23

Raporti me Konventën për njohjen ndërkombëtare të të drejtave mbi mjetet e fluturimit

Kjo Konventë, që zbatohet për mjetet e fluturimit të përkufizuara në këtë protokoll apo për objekte të mjeteve të fluturimit, për çdo shtet që është palë në të, zëvendëson Konventën për njohjen ndërkombëtare të të drejtave mbi mjetet e fluturimit, të nënshkruar në Gjenevë më 19 qershor 1948. Megjithatë, Konventa e Gjenevës nuk zëvendësohet e gjitha përsa i takon të drejtave që nuk trajtohen apo preken nga kjo Konventë.

Neni 24

Raporti me Konventën për unifikimin e disa rregullave në lidhje me sekuestrimin paraprak të mjeteve të fluturimit

1. Konventa, që zbatohet për mjetet e fluturimit të përkufizuara në këtë Protokoll, për çdo shtet që është palë në të, zëvendëson Konventën për Unifikimin e disa rregullave në lidhje me sekuestrimin paraprak të mjeteve të fluturimit të nënshkruar në Romë më 29 maj 1933.

2. Një Shtet Kontraktues që është palë në Konventën e sipërpërmendur, në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit në këtë protokoll, mund të deklarojë që nuk do të zbatojë këtë nen.

Neni 25

Raporti me Konventën UNIDROIT mbi lisingun financiar ndërkombëtar

Konventa zëvendëson Konventën UNIDROIT mbi lisingun financiar ndërkombëtar, të nënshkruar në Otava më 28 maj 1988, për aq sa zbatohet në lidhje me objektet e mjeteve të fluturimit.

KAPITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim në Cape Town më 16 nëntor 2001 nga shtetet pjesëmarrëse në konferencën diplomatike për miratimin e një konvente për pajisjet e lëvizshme dhe të një protokollit për mjetet e fluturimit, të mbajtur në Cape Town nga 29 tetori deri më 16 nëntor 2001. Pas 16 nëntorit 2001, ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga të gjitha shtetet në Qendrën e Institutit Ndërkombëtar për unifikimin e së drejtës private (UNIDROIT) në Romë derisa të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 27.

2. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet që e kanë nënshkruar atë.

3. Çdo shtet që nuk nënshkruan këtë protokoll mund të aderojë në të në çdo kohë.

4. Ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi kryhet duke depozituar për këtë qëllim instrumentin formal tek depozitari.

5. Një shtet nuk mund të bëhet palë në këtë protokoll nëse nuk është ose nuk bëhet gjithashtu palë në Konventë.

Neni 27

Organizatat rajonale të integritit ekonomik

1. Një organizatë rajonale e integritit ekonomik që përbëhet nga shtete sovrane dhe ka kompetencë mbi çështje të caktuara që rregullohen nga ky protokoll mund të nënshkruajë, pranojë, miratojë apo aderojë gjithashtu në këtë protokoll. Në këtë rast Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik, që ka kompetencë mbi çështje të caktuara që rregullohen nga ky protokoll, gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime të një shteti kontraktues. Nëse numri i shteteve kontraktuese është i vlefshëm në këtë protokoll, Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik nuk llogaritet si Shtet Kontraktues së bashku me shtetet e veta anëtare që janë shtete kontraktuese.

2. Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik në momentin e nënshkrimit, pranimit, miratimit apo aderimit, paraqet tek depozitari një deklaratë me shkrim ku specifikon çështjet e rregulluara nga ky protokoll në lidhje me të cilat shtetet anëtare i kanë dhënë kësaj organizate kompetencat e tyre. Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik njofton menjëherë depozitarin në lidhje me çdo ndryshim për shpërndarjen e kompetencës duke përfshirë transferime e reja të kompetencës, të parashikuara në deklaratën sipas këtij paragrafi.

3. Çdo referencë për një "Shtet Kontraktues" apo "Shtete Kontraktuese", "Shtet Palë" apo "Shtete Palë" në këtë Protokoll zbatohet njësoj për një organizatë rajonale të integritit ekonomik nëse kjo kërkohet nga konteksti.

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas kalimit të tre muajve nga data e depozitimit të instrumentit të tetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, ndërmjet shteteve që kanë depozituar këto dokumente.

2. Për shtete të tjera ky protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas kalimit të tretë nga data e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

Neni 29

Njësi territoriale

1. Nëse një Shtet Kontraktues ka njësit territoriale ku zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë protokoll, ai, në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, mund të deklarojë që ky Protokoll të shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në një apo disa prej tyre dhe mund ta ndryshojë deklaratën e tij duke paraqitur në çdo kohë një deklaratë tjetër.

2. Një deklaratë e tillë parashikon shprehimisht njësitë territoriale ky zbatohet ky protokoll.

3. Nëse një Shtet kontraktues nuk ka bërë një deklaratë sipas paragrafit 1, ky protokoll zbatohet për të gjitha njësitë territoriale të atij shteti.

4. Nëse një Shtet Kontraktues e shtron këtë protokoll në një ose disa njësi territoriale, deklaratat e lejuara në bazë të këtij protokollit mund të bëhen në lidhje me çdo njësi territoriale, dhe deklaratat e bëra në lidhje me njësi territoriale mund të jenë të ndryshme nga ato të bëra në lidhje me një njësi tjetër territoriale.

5. Nëse në sajë të një deklaratë të bërë sipas paragrafit 1, ky protokoll shtrihet në një apo disa njësi territoriale të një Shteti Kontraktues:

a) debitori konsiderohet të ndodhet në një Shtet Kontraktues vetëm nëse është themeluar apo formuar në bazë të një ligji në fuqi në një njësi territoriale në të cilën zbatohet kjo Konventë apo ky protokoll apo qendrën statutore, qendrën e administrimit, vendin e aktivitetit apo vendbanimin e zakonshëm në një njësi territoriale ku zbatohet konventa dhe ky protokoll.

b) çdo referencë për vendndodhjen e objektit në një Shtet Kontraktues i referohet vendndodhjes së objektit në një njësi territoriale ku zbatohet Konventa dhe ky protokoll, dhe

c) çdo referencë për autoritet administrative të Shtetit Kontraktues interpretohet sikur i referohet autoriteteve administrative që kanë juridiksion në një njësi territoriale ku zbatohet Konventa dhe ky protokoll dhe çdo referencë për regjistrin kombëtar apo autoritetin e regjistrimit në atë Shtet Kontraktues interpretohet sikur i referohet regjistrit të mjeteve të fluturimit apo autoritetit të regjistrimit që ka juridiksion njësinë apo njësitë territoriale ku zbatohet Konventa dhe ky protokoll.

Neni 30

Deklaratat në lidhje me disa dispozita

1. Në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit të këtij protokollit, një Shtet Kontraktues mund të deklarojë që zbaton një ose më shumë nga nenet VIII, XII dhe XIII të këtij Protokollit.

2. Në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit të këtij protokollit, një Shtet Kontraktues mund të deklarojë që zbaton, tërësisht apo pjesërisht, nenin 10 të këtij protokollit. Nëse bën të njëjtën deklaratë në lidhje me nenin 10(2), duhet të specifikojë periudhën e nevojshme kohore.

3. Në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit të këtij protokollit, një Shtet Kontraktues mund të deklarojë që zbaton të gjithë alternativën A, apo të gjithë Alternativën B të nenit 11 dhe në këtë rast, specifikon llojet e procedurës së falimentimit, nëse ekziston, për të cilën zbaton Alternativën A apo B. Një Shtet Kontraktues që bën një deklaratë sipas këtij paragrafi duhet të specifikojë periudhën e nevojshme kohore të përcaktuar nga neni 11.

4. Gjykatat e Shteteve Kontraktuese zbatojnë nenin 11 në përputhje me deklaratën e bërë nga Shteti Kontraktues që është juridikisht fillestar i falimentimit.

5. Në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit të këtij protokollit, një Shtet kontraktues mund të deklarojë të deklarojë që nuk zbaton, tërësisht ose pjesërisht dispozitat e nenit 21. Deklarata duhet të përcaktojë kushtet sipas të cilave neni zbatohet, në rast se zbatohet pjesërisht, ose në të kundërt, cilat forma të tjera të mbrojtjes së përkohshme zbatohen.

Neni 31

Deklarimet sipas Konventës

Deklarimet e bëra sipas Konventës, duke përfshirë deklaramet që bëhen sipas neneve 39, 40, 50, 53, 54, 55, 57, 58 dhe 60 të Konventës, konsiderohet se janë bërë sipas këtij protokollit, në rast se nuk vërtetohet ndryshe.

Neni 32

Rezervat dhe deklaratat

1. Këtij protokollit nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë, përveç deklarimeve të autorizuar nga nenet 24, 29, 30, 31, 33 dhe 34 në përputhje me këto dispozita.

2. Çdo deklaram apo deklarim i mëvonshëm apo çdo tërheqje i një deklarimi të bërë sipas këtij protokollit i njoftohet me shkrim depozitarit.

Neni 33

Deklarimet e mëvonshme

1. Një shtet palë mund të bëjë një deklarim të mëvonshëm, të ndryshëm nga deklarimi i bërë në përputhje me nenin 31, sipas nenit 60 të Konventës në çdo kohë pas datës në të cilën ky Protokoll ka hyrë në fuqi, duke njoftuar për këtë qëllim depozitarin.

2. Çdo deklarim i tillë i mëvonshëm hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të gjashtë muajve pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari. Nëse për hyrjen në fuqi të deklarimit është parashikuar një afat më i gjatë në njoftim, ai hyn në fuqi me kalimin e këtij afati më të gjatë pas marrjes së njoftimit nga depozitari.

3. Pavarësisht nga paragrafët e mësipërm, ky protokoll zbatohet sikur të mos ishte bërë asnjë deklarim i mëvonshëm, në lidhje me të gjitha të drejtat e lindura para datës së hyrjes në fuqi të deklarimeve të mëvonshme.

Neni 34

Tërheqja e deklarimeve

1. Çdo Shtet Palë që ka bërë një deklaram sipas këtij protokoll, të ndryshme nga një deklaram i autorizuar në bazë të nenit 31, mund ta tërheqë atë në çdo kohë duke njoftuar depozitarin. Kjo tërheqje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të gjashtë muajve pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari.

2. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, ky Protokoll vazhdon të zbatohet, sikur të mos ishte bërë tërheqje e deklaramit, në lidhje me të gjitha të drejtat e lindura para datës së hyrjes në fuqi të tërheqjes.

Neni 35

Denoncimet

1. Çdo shtet palë mund ta denoncojë këtë protokoll duke njoftuar me shkrim depozitarin.

2. Çdo denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të dymbëdhjetë muajve pas datës në të cilën njoftimi merret nga depozitari.

3. Pavarësisht nga paragrafët e mësipërm, ky protokoll vazhdon të zbatohet, sikur të mos ishte bërë asnjë denoncim, në lidhje me të gjitha të drejtat që kanë lindur para datës së hyrjes në fuqi të një njoftimi të tillë.

Neni 36

Konferencat rishikuese, ndryshimet dhe çështjet e lidhura me to

1. Depozitari në këshillim me organin mbikëqyrës, përgatit raporte vjetore, ose në intervale të tilla që mund të kërkohen nga rrethanat për shtetet palë në lidhje me mënyrën në të cilën kuadri i rregullave ndërkombëtare të parashikuara nga Konventa e ndryshuar nga ky protokoll është zbatuar në praktikë.

Gjatë përgatitjes së raporteve të tilla, depozitari merr parasysh raportet e organit mbikëqyrës në lidhje me funksionimin e sistemit ndërkombëtar të regjistrimit.

2. Me kërkesë të jo më pak se njëzet e pesë për qind të Shteteve Palë, Konferencat rishikuese të Shteteve Palë thirren periodikisht nga depozitari, në konsultim me organin mbikëqyrës për të shqyrtuar:

a) zbatimin praktik të kësaj Konvente të ndryshuar nga ky Protokoll dhe efektivitetin e saj për të lehtësuar financimin e bazuar mbi vlera pasurore dhe lisingun e objekteve që rregullohen nga dispozitat e saj;

b) interpretimin gjyqësor të dhe zbatimin e bërë për dispozitat e protokollit dhe rregulloreve;

c) funksionimin e sistemit ndërkombëtar të regjistrimit, aktivitetin e regjistruarit dhe mbikëqyrjen e ushtruar nga organi mbikëqyrës, duke marrë parasysh raportet e organit mbikëqyrës; dhe

d) nëse janë të nevojshme ndryshime në protokoll ose rregullat në lidhje me regjistrin ndërkombëtar.

3. Çdo ndryshim i këtij Protokoll miratohet të paktën nga 2/3 e shumicës së Shteteve Palë pjesëmarrëse në Konferencën e përmendur në paragrafin e mësipërm dhe pastaj hyjnë në fuqi në lidhje me shtetet që e kanë ratifikuar, pranuar apo miratuar këtë ndryshim kur është ratifikuar, pranuar apo miratuar nga 8 shtete në përputhje me dispozitat e nenit 18 që lidhen me hyrjen e tij në fuqi.

Neni 37

Depozitari dhe funksionet e tij

1. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen në Institutin Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private (UNIDROIT) që këto emërohet depozitues.

2. Depozitari:

a) informon të gjithë Shtetet Kontraktues për:

i) çdo nënshkrim ose depozitim të ri të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi së bashku me datën e tij;

ii) datën e hyrjes në fuqi të këtij protokoll;

iii) çdo deklaratë të bërë në pajtim me këtë protokoll, së bashku me datën e saj;

iv) tërheqjen ose ndryshimin e çdo deklarate, së bashku me datën e saj, dhe

v) njoftimin e çdo denoncimi të këtij protokollit së bashku me datën e saj dhe datën në të cilën hyn në fuqi;

b) u transmeton kopje të vërtetuara të këtij protokollit të gjitha Shteteve Kontraktues;

c) i jep organit mbikëqyrës dhe regjistruarit kopje të çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi së bashku me datën e depozitimit të tyre, të çdo deklarate apo tërheqjeje apo ndryshimi në të deklarate dhe çdo njoftimi denoncimi, së bashku me datën e njoftimit të tyre, në mënyrë që informacioni që përmbahet në to të bëhet i ditur lehtësisht dhe plotësisht; dhe

d) kryhen edhe funksione të tjera që janë të zakonshme për depozitarin.

Me praninë e tyre, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, të autorizuar rregullisht, nënshkruan këtë protokoll.

Nënshkruar në Cape Town më 16 nëntor 2001, në një origjinal të vetëm në gjuhën angleze, arabe, franceze, kineze, ruse dhe spanjolle dhe secili prej teksteve është njësoj autentik; ku autencitet hyn në fuqi me verifikimin e Sekretariatit të Përbashkët të Konferencës nën autoritetin e Presidentit të Konferencës brenda

nëntëdhjetë ditëve duke filluar nga kjo datë, në lidhje me përputhshmërinë e teksteve me njëri-tjetrin.

Formulari i autorizimit të kërkesës për çregjistrim dhe leje për eksport

Aneksi i përmendur në nenin 13

[Shëno datën]

Për: [Shëno emrin e autoritetit të regjistrimit]

Re: Autorizimi i pakthyesëm i kërkesës për çregjistrim dhe lejes për transport.

i nënshkruari është regjistruar [operator] [pronar]* i [shëno emrin e prodhuesit të strukturës së mjeteve të fluturimit /helikopterit dhe numrin e modelit] me numër serial të prodhuesit [shëno numrin serial të prodhuesit] dhe [numër] [markë regjistrimi] [shëno numrin/ markën e regjistrimit] (së bashku me të gjithë aksesoret e instaluar, të përfshirë apo fiksuar, pjesët dhe pajisjet “avion”).

Ky dokument është një autorizim i kërkesës për çregjistrim dhe leje eksporti e lëshuar nga i nënshkruari në favor të [shëno emrin e kreditorit] (“pala e autorizuar”) sipas autoritetit të nenit 13 të protokollit të Konventës mbi Garancinë Ndërkombëtare, në pajisjet e lëvizshme në lidhje me pajisjet e avionëve. Në përputhje me këtë nen i nënshkruari i kërkon si më poshtë:

i) që pala e autorizuar ose personi që caktohet prej saj të njihet si i vetmi person që gëzon të drejtën të:

a) sigurojë çregjistrimin e avionit nga [shëno emrin e regjistrimit të aeroplanit] të mbajtur nga [shëno emrin e autoritetit të regjistrimit] për qëllimet e kapitullit III të Konventës mbi Aviacionit Civil Ndërkombëtar të nënshkruar më 7 dhjetor 1944 m dhe

b) sigurojë eksportin dhe transferimin fizik të avionit nga [shëno emrin e vendit]; dhe

ii) konfirmimin që pala e autorizuar ose personit që caktohet prej saj të marrë masën e specifikuar në klauzolën (i) me kërkesë me shkrim pa miratimin e të nënshkruarit dhe që, me këtë kërkesë, autoritetet në [shëno emrin e vendit] të bashkëpunojnë me palën e autorizuar me qëllim që të përshpejtohet përfundimi i këtij veprimi.

Të drejtat në favor të palës së autorizuar të përcaktuara në këtë dokument nuk mund të shfuqizohet nga i nënshkruari pa miratimin me shkrim të palës së autorizuar.

*Zgjidh termin që pasqyron kriterin e duhur të regjistrimit të kombësisë.

Ju lutemi bëni të ditur që bini dakord me këtë kërkesë dhe kushtet e saj me shënimin e duhur në hapësirën më poshtë dhe depozitoni këtë dokument në [shëno emrin e autoritetit të regjistrimit].

[shëno emrin e operatorit/pronarit]